



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti Juridik

Studimet Master – Drejtimi Penal

PUNIM DIPLOME

**GRABITJA DHE VJEDHJA GRABITQARE SIPAS KODIT
PENAL TË KOSOVËS, ME VËSHTRIM TË VEÇANT NË
TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE NË GJAKOVË NË
PERIUDHËN 2008 - 2012**

*Mentori:
Prof. Ismail Zejneli*

*Kandidati:
Alban Gjoshi*

Tetovë, 2018

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

1. ASPEKTET JURIDIKO-PENALE TË VEPRAVE PENALE TË GRABITJES DHE VJEDHJES GRABITQARE

1.1 Vështrime hyrëse

- 1.2 Historiku i veprave penale kundër pasurisë.....
1.2.1 Historiku i veprave penale kundër pasurisë sipas të drejtës zakonore penale Shqiptare.....
1.2.2 Historiku i veprave penale kundër pasurisë sipas Ligjit Penal të KSA të Kosovës.....
1.3 Vjedhja grabitqare dhe grabitja në të drejtën penale komparative.....
1.3.1 Veprat penale kundër pasurisë në legjiislacionin penal të Shqipërisë dhe në shtetet tjera.....

KAPITULLI II

2. VEPRAT PENALE TË VJEDHJES GRABITQARE DHE GRABITJES SIPAS KODIT PENAL TË KOSOVËS

- 2.1 Llojet e veprave penale kundër pasurisë.....
2.2 Karakteristikat themelore të veprave penale kundër pasurisë
- 2.3 Vepra penale e vjedhjes grabitqare.....
2.3.1 Nacioni, përkufizimi, veprimi i kryerjes, kryesi dhe viktima te vepra penale e vjedhjes grabitqare.....
2.3.2 Format e kryerjes të veprës penale të vjedhjes grabitqare.....
2.3.2.1 Vjedhja grabitqare e kryer ndaj personit të rastit.....
2.3.2.2 Vjedhja grabitqare e kryer me hyrjen në shtëpi, banesë ose lokal afarist.....
2.3.2.3 Vjedhja grabitqare e kryer me armë dhe nga më shumë persona...
- 2.4 Vepra penale e grabitjes.....
2.4.1 Nacioni, përkufizmi, veprimi i kryerjes, kryesi dhe viktima të vepra penale e grabitjes.....
2.4.2 Format e kryerjes të veprës penale të grabitjes.....

2.4.2.1	Grabitja e kryer ndaj personit të rastit.....
2.4.2.2	Grabitja e kryer në pusi.....
2.4.2.3	Grabitja e kryer në bazë të shoqërimit paraprak me viktimen...
2.4.2.4	Grabitja e kryer me hyrjen në shtëpi – banesë.....
2.4.2.5	Grabitja me vënien e pusise ndaj inkasantit apo postierit.....
2.4.2.6	Grabitja e kryer e armatosur në institucionet financiare – banka, postë, KEK.....
2.4.2.7	Simulimi (fingimi) i grabitjes.....
2.5	Rastet e rënda të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes.....
2.5.1	Përgjegjësia penale e bashkë kryesve për rastet e rënda të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes
2.6	Dallimet dhe ngashmëritë në mes të vepres penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes.....

KAPITULLI III

3. ASPEKTET KRIMINOLOGJIKE TË VEPRAVE PENALE TË VJEDHJES GRABITQARE DHE GRABITJES

3.1.	Fenomenologjia e veprave penale kundër pasurisë.....
3.1.1.	Fenomenologjia e veprave penale kundër pasurisë.....
3.1.2.	Fenomenologjia e recidivizmit të veprave penale kundër pasurisë.....
3.1.3.	Ecuria dhe dinamika e veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, në periudhën: 2008 – 2012.....
3.2.	Etiologjia e veprave penale kundër pasurisë.....
3.2.1	Shkaqet e veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare.....
3.2.2	Faktorët kriminogen të veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare.....
3.2.3	Tipologjia e krimineleve.....
3.3.3	Kryesit e veprave penale kundër pasurisë.....

4 PARANDALIMI DHE LUFTIMI I VEPRAVE PENALE TË VJEDHJES GRABITQARE DHE GRABITJES

- 4.1 Politika kriminale për parandalimin dhe luftimin e veprave penale kundër pasurisë.....
4.1.1 Faktorët preventive (themelor, ndërkombëtare dhe shkencor).....
4.1.2 Faktorët represiv – institucional (Policia, Prokuroria, Gjykatat dhe Entet korrektuese).....
4.1.3 Politika ndëshkimore – ndikimi i sanksioneve penale dhe ekzekutimi i tyre në parandalimin e veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare.....
4.1.4 Luftimi i kriminalitetit pasurorë si pjesë e Stratëgjisë Kombëtare për luftimin e kriminalitetit.....

PËRFUNDIMI.....

LITERATURA.....

KAPITULLI – I

1. ASPEKTE JURIDIKO-PENALE TË VEPRAVE PENALE TË GRABITJES DHE VJEDHJES GRABITQARE

1.1 Vështrime hyrëse

Po kështu, edhe çlirimi dhe pavarësimi i Kosovës nga Serbia, shënoi ecjen e saj drejtë botës së civilizuar mbi bazën e kushteve të ekonomisë së tregut dhe lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave. Këto kushte krijuan një ambient të favorshëm për konfrontimin e shoqërisë civile me problemet sociale. Problemët sociale të shprehura pas luftës (kufizimi i vendit tonë me shtetet e dalura nga lufta, posedimi enormë i armëve pa leje, procesi i tranzicionit, etj...), paraqesin faktorë potencial për paraqitjen dhe zhvillimin e dukurive të rrezikshme si: trafiku i drogës, krimi i organizuar, dhe forma tjera të manifestimit të kriminalitetit. Në këtë kontekst, veprat penale kundër pasurisë, e në veçanti veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe trajtat e tyre të cilësuara gjithashtu kanë evoluar në format e tyre të manifestimit.

Hulumtimi i aspekteve juridiko-penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes, nënkuption: analizen teorike, praktiken gjyqësore dhe zgjidhjet aktuale në të drejtën penale komparative.

Zgjidhjet juridiko-penale të legjislacionit tonë në sferën e krimeve kundër pasurisë përkojnë me mbrojtjen e të drejtave pronësore në rrafshin juridiko-penal. Institucionet komponente mbrojnë të gjithë personat që u kërcënohet jeta apo prona, për shkak të veprimeve të kundërligjshme të ndërmarrura nga personi i caktuar. Në literaturë kjo mbrojtje karakterizohet si subsidiare¹. Është subsidiare, sepse ka të bëjë me cenimin e të drejtave pronësore, kryesisht të sendeve të luajtshme. Mirëpo, pavarësisht nga vëllimi i kufizuar i mbrojtjes juridiko-penale të pasurisë, rëndësia e kësaj mbrojtjeje është e pamohueshme dhe specifike. Legjislacioni ynë penal, i pavarur dhe i mbështetur në parimet më të avancuara të demokrative perëndimore, miratoi Kodin penal – 2003, dhe në kapitullin XXIII sistemoi veprat penale kundër pasurisë, ku përveç veprave penale klasike (vjedhja, grabitja, vjedhja grabitqare...) janë përfshirë edhe vepra penale të cilat tërthorazi cenojnë pasurinë². Në tetor të vitit 2012 është aprovuar Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës (i aplikueshëm nga 01.Janar 2013), sipas të cilit veprat penale kundër pasurisë trajtohen në kapitullin XXVII. Numrin e këtyre veprave penale, ndryshimet e bëra dhe përbajtjen e tyre do ta trajtojmë në kapitullin e II (dytë).

1.2 Historiku i veprave penale kundër pasurisë

Me kriminalitet kundër pasurisë, nënkuptohen të gjitha veprimet që cenojnë dhe rrezikojnë pasurinë private dhe shtetërore. Krimet kundër pasurisë janë të njohura që nga kohërat me të lashta,

¹ Salihu, Ismet, Hasani, Fejzullah dhe Zhitia, Hilmi, " Komentari i KPRK-së", Prishtinë, 2012, fq.907;

² Po aty, fq.908;

këto krime bëjnë pjesë në kriminalitetin klasik, kjo nuk do të thotë se format e paraqitjes së disa krimeve kundër pasurisë nuk kanë pësuar ndryshime dhe se nuk janë lajmeruar forma të reja. Me zhvillimin e teknikes, elektronikës dhe përsosjes së industrisë është mundësuar që krimet të kryhen më shpejt dhe të vështirësohen zbulimi i tyre³. Me vepra penale kundër pasurisë nënkuptoohen ato vepra penale që shfaqen në marrjen e sendit të huaj me qëllim përfitimi material për vete ose në dobi të personave tjerë ose në dëmtimin apo shkatërrimin e tyre⁴.

Periudha e bashkësisë së parë njerëzore, në këtë periudhë ngjanin ekcese që i cenonin rregullat e jetës shoqërore të bazuara në të drejtën zakonore, është dashur patjetër të reagohet ndaj personave që kryenin këto ekcese, përshkak se akoma nuk ishte formuar shteti dhe e drejta, këtë reagim e ushtronte familja apo fisi dhe kishte për qëllim që ta mbronte bashkësinë nga veprat e tillë të dëmshme, ky reagim ka pasur karakter të mbrojtjes shoqërore⁵.

Shqyrtimi i plotë i reagimit ndaj kriminalitetit nxjerrë në pah këto çështje juridiko-penale:

- Përcaktimi i veprimeve të rrezikshme të cilat paraqesin vepra penale;
- Sanksioni ndaj këtyre veprave penale; dhe
- Ekzekutimi i sanksioneve të shqiptuara, me qëllim të realizimit të qëllimit të ndëshkimit.

1.2.1 Historku i veprave penale kundër pasurisë sipas të drejtës zakonore shqiptare

Në territorin e Kosovës, në Republikën e Shqipërisë dhe në viset e tjera etnike shqiptare, nuk janë ruajtur monumente juridike të periudhës para Luftës së Parë Botërore, në bazë të të cilave do të mund të krijonim një përfytyrim të plotë për karakterin e së drejtës penale të asaj kohe. Gjatë kësaj periudhe në Kosovë, në Shqipëri dhe në viset e tjera etnike shqiptare, në masën më të madhe aplikohej e drejta zakonore, në kuadrin e së cilës edhe e drejta zakonore penale. Pjesa më e madhe e së drejtës zakonore shqiptare që emërtuar Kanuni i Lekë Dukagjinit, dhe Kanunet tjera. Këto kanune, së bashku me Kanunin e Lekë Dukagjinit, përbëjnë burimet kryesore të së drejtës zakonore penale shqiptare. Sipas këtyre kanuneve, veprat penale ishin të sistemuara si vijon: veprat penale kundër personit, kundër familjes dhe martesës, kundër pronës private, kundër kishës dhe veprat e tjera penale.⁶

³ Ragip Halili, "kriminoligjia", Prishtinë, 2005, fq.205-206;

⁴ Imaïl Zejneli, "E drejta penale - pjesa e posaçme", Tetovë, 2007, fq.111-112;

⁵ Salihu, Ismet, "E drejta penale - pjesa e përgjithshme, Prishtinë, fq.70;

⁶ Salihu Ismet, Hasani Fejzullah dhe Zhitia Hilmi, "Komentari i Kodit Penal i Rep. së Kos.", Prishtinë, 2014, fq.31;

Në *shoqërinë e paorganizuar* (...nuk kishte shtet...), familja aplikonte masat mbrojtëse dhe ndëshkuese ndaj kryesve të veprave, me të cilat rrezkohej interes i familjes. Këto masa ishin: dëbimi, hakmarrja, gjakmarrja, shpagimi, etj⁷.

Në *periudhën antike*, edhe në Kosovë, “mbrojtja juridike” reflektonte statusin e pronësisë, si ndaj njeriut ashtu edhe ndaj sendeve, këtu bëhet fjalë për pronën private në përgjithësi. Pronari ishte niveli suprem i cili përcaktonte objektin mbrojtës, respektivisht, aktin se cilat veprime paraqesin rrezikshmëri për të cilat ndaj kryesit të tyre duhet caktuar masat ndëshkuese.

Gjatë *periudhës së mesjetës*, në Kosovë janë aplikuar normat e perandorisë osmane (sheriat i Kodi Penal i Turqisë i vitit 1868) si dhe e drejta zakonore shqiptare (kanunet e shumta sikurse ai i Lekë Dukagjinit, Skënderbeut, i Maleve, i Labërisë etj)⁸.

E *drejta zakonore penale shqiptare* – si disiplinë e posaçme e të drejtës zakonore shqiptare paraqet tërësin e rregullave, normave juridiko-penale të pashkruara, të cilat u krijuan gjatë shekujve dhe u barten brez pas brezi, me të cilat mbroheshin raportet më vitale të njeriut. Këto norma nuk janë të sistemuara sipas natyrës së tyre juridiko-penale dhe parimeve të teorisë së të drejtës penale. E drejta zakonore penale shqiptare i ka kushtuar një rëndësie të veçantë mbrojtjes së pasurisë së personave fizik dhe të bashkësisë shqiptare. Në këtë drejtim ka inkriminuar vjedhjen, grabitet, prejen, mashtimin, dëmtimin e pasurisë, dhe ka paraparë dënimet përkatëse. Kështu, nëse grabitet çka do nga pasuria në shtëpi, dëban, vathe etj, kryesi detyrohet të kthejë sendin, të paguaj edhe gjobën për shkeljen e nderit të familjes dhe shtëpisë në të cilën është kryer vepra dhe vathin e thyer⁹.

E *drejta zakonore sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit* – Emërtimi i Kanunit buron nga fjala greke kanon që nënkuption rregull. Kanuni i Lekë Dukagjinit është përbledhje e rregullave dhe zakoneve të cilat i ka grumbulluar princi i Dukagjinëve – Lekë Dukagjini. Kanuni irregullon çështjet jetike të shqiptarëve të asaj kohe. Përveç normave tjera përmban edhe norma të cilat duhet theksuar së janë të pakta, me të cilat nëse mund të thuhet, janë rregulluar disa institucione të përgjithshme të së drejtës penale, dhe në këtë kontekst edhe disa vepra penale kundër pasurisë. Kanuni ka 12 libra, 24 krye, 259 nyje dhe 1263 paragrafë. Kanuni ka paraparë këto dënimë: gjakmarrje, dënimin me vdekje, dëbimin, djegien e shtëpisë, rrënimin e pasurisë, prerjen e pemëve dhe të lënët e tokës djerrë, gjobën dhe lëcitet¹⁰.

⁷ Salihu, Ismet “e Drejta Penale”, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, fq.70-72;

⁸ Po aty, fq.110-111

⁹ Ukaj, Bajram, “Dënimet në të Drejtën Penale të Shqipërisë”, Prishtinë, 2006, fq.37-59;

¹⁰ Shtjefen Gjeçovi O.F.M., “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Tiranë, 1999

Në nenin (nye) 113, në paragrafet prej 777 deri në 781, parashihen veprimet dhe ndëshkimet për këto veprime, e të cilat paraqesin vepër të grabitjes. Këto norma, sipas përbajtjes së tyre parashohin:

- Grabitet e kafshëve (kalin, mushkin etj...)
- Përcakton gjobën dhe kompensimin për ditët e humbura, të cilën sipas peshës së fajta e cakton katundi dhe obligon grabitqarin në kthimin e kafshëve.

Duke patur parasysh marrëdhëniet shoqërore – ekonomike të kohës, Kanuni kishte karakter klasor, ngasë në veçanti mbronte klasën feudale, pronën private dhe kishën¹¹.

Rëndësia e Kanunit në historinë e popullit shqiptarë mund të mbivlerësohet pak, por rregullat dhe normat e tij vazhdojnë ende të ushtrojnë ndikim dhe atë të ndjeshëm ndër shqipëtarët që jetojnë në trojet e tyre etnike si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi dhe Kosovën Lindore. Kanuni i Lekë Dukagjinit, në librin e dhjetë (Kanuni Kundra mbrapshtive), në kreun e 21, ka paraparë:

- . në nenin (nye) 112, parashihet – vjedhnija;
- . në nenin (nye) 113, parashihet – grabitja;
- . në nenin (nye) 114, parashihet – (preja) premtimi;
- . në nenin (nye) 115, parashihet – faji i kobshëm;
- . në nenin (nye) 116, parashihet – dypernjahja; dhe
- . në nenin (nye) 117, parashihet – tagri i gjasë së vjedhun.

1.2.2 Historiku i veprave penale kundër pasurisë sipas Ligjit Penal të KSA të Kosovës.

Pas përmbytjes së perandorisë osmane, Kosova ishte okopuar nga Serbia, kështu që u aplikuan ligjet e Mbretërisë serbo – kroate – sllovene. Në vitin 1929 u aprovue Kodi Penal i Mbretërisë SKS¹².

Pas përfundimit të luftës së dytë botërore, Kosova përsëri okupohet, tanë nga okupatori i quajtur Jugosllavi, e cila me rregullimin e saj kushtetues Kosovën e vënë nën juridikcionin e Sërbisë (si përbërëse të saj).

Ky status e zhvesh Kosovën nga çdo formë e mëvetësisë së saj, kështu që edhe çështjet në lëmin e legjislacionit penal rregulloheshin nga Serbia, respektivisht Jugosllavia. Nga arsyet e cekura, për periudhën 1946-1977 mund të konstatojmë se Kosova nuk kishte kompetenca në lëmin e legjislacionit

(...përcaktimi i veprave penale; sanksionimi dhe ekzeutimi i tyre ishin të rregulluara me ligjet e Sërbisë – Jugosllavisë...)¹³.

Sikurse edhe për veprat tjera penale, edhe veprat penale kundër pasurisë përcaktoheshin me ligje të Sërbisë, gjegjësisht Jugosllavisë. Kështu, legjislacioni i atëhershëm penal në kuadër të veprave

¹¹ Salihu, Ismet, " E Drejta Penale", pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, fq.111

¹² Po aty, fq.110-118

¹³ ismet Salihu - E Drejta Penale - Pjesa e pergjithshme, Prishtinë, 2015, fq.112-114;

penale kundër pasurisë ka paraparë edhe veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastet e rënda të këtyre veprave.

Ky ligj është aplikuar deri në aprovimin e Kodit Penal të Kosovës të vitit 2003, i cili kod është ndryshuar disa herë. Në vitin 2012 është aprovuar Kodi i ri Penal i Kosovës. Duhet theksuar se elementet themelore të cilat përbëjnë qenien e veprave penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastet e rënda të këtyre veprave penale të parapara me Kodin Penal të Kosovës të vitit 2003, nuk dallojnë në esencë nga dispozita e LPK-së me të cilat janë rregulluar këto vepra penale.

Në këtë aspekt, përcaktimi i këtyre veprave me Kodin e ri Penal të Kosovës të vitit 2012, janë paraparë ndryshime të cilat konsistonjë në faktin se, rastet e rënda (të cilësuara-kualifikuara) të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes nuk janë paraparë me nen të veçantë, veçse janë përfshirë në përbajtjen e veprave përkatëse. (Vërejtje: për këto dallime do të elaborohet në kaptinen e dytë).

1.3 Vjedhja grabitqare dhe grabitja në të drejtën penale komparative

Në kuptimin juridiko-penal, vjedhja grabitqare dhe grabitja karakterizohen me ndërlikimin e kryerjes së tyre. Fjala është për vepra të përbëra penale, objekti mbrojtës i të cilave është pasuria, ndërsa atribut tjetër i tyre është përdorimi i dhunës. Për shkak të kontaktit me subjektin pasiv, këto vepra penale renditen në kategoritë e “kontakt i kriminalitetit”¹⁴. Në të drejten bashkëkohore penale, nacioni i veprave penale kundër pasurisë përcaktohet në mënyra të ndryshme.

Këto dallime kryesisht kanë të bëjnë me:

- . Elementet të cilat përcaktojnë figuren e veprës penale;
- . Trajtat e paraqitjes;
- . Rrethanat të cilat përcaktojnë cilësimin e veprës përkatëse penale;
- . Numrin e veprave penale kundër pasurisë; si dhe
- . Sanksionet penale të parapara për këto vepra penale.

Në legjislacionet e huaja penale, veprat penale kundër pasurisë janë përcaktuar në tri mënyra:

- . Përcaktimi i këtyre veprave në një kapitull të ligjit penal (...Suedia, Danimarka, Greqia...);
- . Përcaktimi i këtyre veprave në një kapitull të ligjit penal, por në kuadër të kapitullit sistemohen në më shumë njesi të veçanta (...Itali, Zvicër, Gjermani... etj); dhe

¹⁴ Zvekić, U “žrtve kriminala u zemljama u tranziciji” Beograd, 2001, fq.34;

. Përcaktimi i këtyre veprave në më shumë krerë të veçantë (...Norvegjia...)¹⁵.

Në kushtet kur në Kosovë bëhen përpjekje për reforma thelbësore në legjislacionin penal (miratimi i Kodit të ri Penal dhe Kodit të Procedurës Penale), paraqitet e domosdoshme njohja me zgjidhjet juridike në legjislacionet penale të shteteve tjera.

1.3.1 Vepra penale kundër pasurisë në legjislacionin penal të Shqipërisë dhe në shtetet tjera

Në të drejtën penale Shqiptare, veprat penale kundër pasurisë janë:

. Veprat penale që kanë të bëjnë më përvetësimin e pasurisë në pronësi të personave fizikë, juridik dhe të shtetit; dhe

. Veprat penale të cilat lidhen me shkatërrimin ose dëmtimin e pasurisë¹⁶.

Edhe Kodi Penal i Shqipërisë trajton në këtë mënyrë veprat penale kundë pasurisë. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë* (i miratuar me Ligjin nr.7895, dt.27.01.1995, dhe hynë ne fuqi me 01.06.1995, ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2001, 2003, 2004, 2007 dhe 2008), në pjesën e posaçme, në kreun e III, ne tri seksione ka paraparë veprat penale kundër pasurisë dhe atë:

1. Seksioni i I – vjedhja e pasurisë / Në kuadër të këtij seksioni vërehet se nuk kemi vepra penale të emërtuara si grabitje dhe vjedhje grabitqare, por kemi tre vepra penale të emërtuara si: *vjedhje me dhunë* – neni 139, e dënueshme me burgim nga 5 – 15 vjet; *vjedhje me armë* – neni 140, e dënueshme me burgim nga 10 – 20 vjet; dhe *vjedhje me pasojë vdekje* – neni 141, e dënueshme me burgim nga 15 gjerë në 25 vjet ose me burgim të përjetshëm/;
2. Seksioni i II – mashtrimet / parasheh 8 vepra penale (nga neni 143 deri në nenin 149 të KPSH-së); dhe
3. Seksioni i III – shkatërrimi i pronës / parasheh 2 vepra penale (nga neni 150 deri në nenin 161 të KPSH-së)¹⁷.

Duhet theksuar se, inkriminimi – sanksionimi i këtyre veprave penale, e të paraqitura në tri seksionet e nxjerrë në pah se vjedhja me dhunë, si në trajtimin teorik ashtu edhe atë praktikë konsumon përdorimin e dhunës, si para aktit të vjedhjes ashtu edhe pas marries së sendit, që nënkupton se nuk sanksionohen si vepra të ndara penale¹⁸. Në këtë kuadër, vlen të përmendet se Kodi Penal i Shqipërisë nuk parashikon si rrethanë cilësuese vjedhjen me dhunë të kryer në bashkpunim ose në grup të strukturuar.

¹⁵ Srzentić, Nikola, "Komentar krivičnog Zakona Srbije, SAP Kosova i Sap Vojvodine", Beograd, 1981, fq.482;

¹⁶ Ismet Elezi, "E drejta penale "pjesa e posaçme", Tiranë, 2003, fq.203;

¹⁷ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (Ligji nr.7895, dt.27.01.1995);

¹⁸ Në shumë legjislacione, e edhe në KP – të Kosovës, këto veprime janë inkriminiuar si grabitje – përdorimi i dhunës për ta vjedhur sendin dhe vjedhje grabitqare – përdorimi i dhunës për ta mbajtur sendin;

2.2.Kodi Penal i Republikës së Magedonisë – 1996 (ndryshuar dhe plotësuar disa herë), në kreun XXIII, ka paraparë 29 vepra penale kundër pasurisë dhe në nenin 237 sanksionon vepren penale të plaçkitjes: (1) Ai që me përdorimin e forcës ose me kërcënrim se drejtpërdrejt do të sulmojë mbi jetën ose trupin e tjetrit do të merr send të huaj të luajtshëm me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ta përvetësojë, do të dënohet me burg më së paku pesë vjet.

(2) Nëse vlera e sendit të marrë është në përmasa të mëdha, kryesi do të dënohet me burg më së paku tetë vjet.

(3) Nëse vlera e sendit të marrë është më e vogël dhe kryerësi ka synuar që të përvetësojë send me vlerë të atillë, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi 1 deri në 3 të këtij neni ndonjë personi me paramendim i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor ose nëse vepra është kryer në përbërje të grupit, bandës ose nëse është përdorur armë zjarri ose mjet i rrezikshëm ose nëse gjatë zbatimit të veprës në bankë, këmbimore, postë ose në vend publik është rrezikuar jeta ose trupi i dy ose më shumë personave, kryesi do të dënohet me burg më së paku dhjetë vjet.

(5) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi (1) ndonjë person me paramendim është privuar ngajeta, kryesi do të dënohet me burg më së paku dhjetë vjet ose me burg të përjetshëm.

, ndërsa në nenin 238 veprën penale grabitja e armatosur: (1) Ai që, i kapur në aktin e vjedhjes, do të përdorë forcë ose kërcënrim se do të sulmojë mbi jetën ose trupin e tjetrit me qëllim që ta mbajë sendin e vjedhur, do të dënohet me burg më së paku pesë vjet.

(2) Nëse vlera e sendeve të vjedhura është në përmasa të mëdha, kryesi do të dënohet me burg më së paku tetë vjet.

(3) Nëse vlera e sendit të marrë është më e vogël dhe kryerësi ka synuar që të përvetësojë send me vlerë të atillë, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi (1) deri në paragrafin (3) të këtij neni ndonjë personi me paramendim i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor ose nëse grabitja e armatosur është kryer në përbërje të grupit ose bandës ose nëse është përdorur armë zjarri ose mjet i rrezikshëm ose nëse gjatë kryerjes së veprës në bankë, këmbimore, postë ose në vend publik është rrezikuar jeta ose trupi i dy ose më shumë personave, kryesi do të dënohet me burg më së paku dhjetë vjet.

(5) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi (1) ndonjë person me paramendim është privuar ngajeta, kryesi do të dënohet me burg më së paku dhjetë vjet ose me burg të përjetshëm¹⁹.

2.3.Ligji Penal i Kroacisë – 1997 (ndryshuar dhe plotësuar disa herë), në pjesën e posaçme, ne kreun XVII, parashev 25 vepra penale kundër pasurisë, dhe në nenin 230 sanksionon vepren penale

¹⁹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë me ndryshime te reja;

të grabitjes, ndërsa në nenin 231 veprën penale të vjedhjes grabitqare, të dënueshme me burgim prej 1 viti deri me 10 vjet burgim. Për këto vepra penale me pasoja të vdekjes, kryesi dënohet së paku 5 vjet burgim ose 20 vjet burgim²⁰.

2.4.Kodi Penal i Bullgarisë, në nenin 198 dhe 199 parasheh 2 (dy) vepra penale të grabitjes;

. Sipas dispozitave të nenit 198 vepra penale e grabitjes përbëhet nga përdorimi i forcës apo kërcënimit e me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore; dhe

. Sipas dispozitave të nenit 199 kur grabitja kryhet nga më shumë persona, dhe me këtë rast shkaktohet lëndim i rëndë trupor apo vdekja e viktimës²¹.

2.5.Kodi Penal i RF. të Gjermanisë - numëron me shumë vepra penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, kështu që:

. Sipas nenit 249, parashihet rast i lehtë i marrjes së sendit të huaj me përdorimin e forcës apo kërcënimit;

. Sipas nenit 250, parashihet grabitja e rëndë – me armë, e kryer nga banda; dhe

. Sipas nenit 252, parashihet vjedhja grabitqare²².

2.6.Kodi Penal i Sllovenisë – 1994 (ndryshuar dhe plotësura disa herë), sanksionon veprën penale të grabitjes (neni-206) dhe veprën penale të vjedhjes grabitqare (neni-207) me dënim burgimi prej 1 – 10 vjet, gjegjësisht deri në 15 vjet²³.

2.7.Kodi Penal i Malit të Zi – në pjesën e posaçme, në kreun XXI, parasheh 19 vepra penale kundër pasurisë, dhe në nenin 241 sanksionon veprën penale të vjedhjes garbitqare, ndërsa në nenin 242 veprën penale të grabitjes, të dënueshme me burgim prej 1 deri në 30 vjet²⁴.

2.8.Kodi Penal i Sërbisë – në pjesën e posaçme, në kreun XXII, parashihen 21 vepra penale kundër pasurisë, dhe në nenin 167 sanksionon veprën penale të vjedhjes grabitqare, e dënueshme prej 1 deri në 12 vjet, ndërsa në nenin 168 veprën penale të grabitjes, e dënueshme me burgim së paku 3 vjet. Në rastet e rënda të këtyre veprave penale, të cilat për pasojë kanë vdekjen e viktimës, kryesi dënohet prej 12 – 40 vjet²⁵.

2.9.Kodi Penal i Bosnje e Hercegovinës - nuk përmban pjesën e posaçme të legjisacionit penal, sepse, sanksionimi i veprave penale është në kompetencë të entiteve. Kështu, Ligji i Federatës së

²⁰ Ligji Penal i Kroacisë (SG.Br.110/97, 27/98.....57/11 i 143/12);

²¹ Dragan, Jovašević – “Krivična dela razbojničke krade i razbojnijstva u teoriji i praksi i uporednom pravu”, Bezbednost, 2/2002, str.264;

²² Po aty, fq.265;

²³ Kazenski Zakonik Slovenije (Ur.I. RS. 63/94, 70/94, 23/99, 60/99, 11/2002,.....55/2008 dhe 5/2009);

²⁴ Kodi Penal i Malit të Zi (SG.br.70/04,...13/04);

²⁵ Kodi Penal i Sërbisë (“SL. Glasnik RS, br.85/2005, 72/2009, i 121/2012);

B e H-së, në pjesën e posaçme parasheh 16 vepra penale kundër pasurisë, dhe në nenin 288 sanksionon veprën penale të vjedhjes grabitqare, ndërsa në nenin 289 sanksionon veprën penale të grabitjes, të dënueshme me burgim prej 1 viti ose dënim burgu afatgjatë.

2.10. Ligji Penal i Republikës serbe – 2003, në pjesën e posaçme, në kreun XXIII, parasheh 24 vepra penale kundër pasurisë, dhe në nenin 233 sanksionon veprën penale të grabitjes, ndërsa në nenin 234 sanksionon veprën penale të vjedhjes grabitqare, të dënueshme me burgim prej 1 viti ose me burgim afatgjatë²⁶.

Korpusi i veprave kundër pasurisë, në legjislacione të ndryshme dallon edhe për nga emërtimi. Kryesisht, këto vepra emërtohen si: vepra penale kundër pasurisë (...më shpesh kështu emërtohen...), vepra penale kundër pronës; vepra penale kundër të mirave; ose krime dhe vepra të kryera me qëllim të përvetësimit të interesit (shembull: Ligji Penal i Danimarkës)²⁷.

Pasqyra e cekur më lartë lejon konstatimin se legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë parasheh sanksione pothuaj kapitale për veprat penale kundër pasurisë. Shembull: për veprën penale të kryer me dhunë, e që për pasojë është shkaktuar vdekja e personit – me nenin 141, parashihet dëndimi me burgim prej 15 – 25 vjet ose me burgim të përjetshëm.

Mbështetur në sferën e interesit tonë (...veprat penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare...), trajtimi juridiko-penal i veprave penale kundër pasurisë në përgjithësi, dhe veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare në veçanti, paraqet sfidë, të cilës do të përipiqem t'i japim përgjigje adekuate. Natyrisht, jam i vetëdijshëm se, për të nxjerrë përfundime konkrete, të kapshme e të përdorshme në planin e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit, objekti i studimit kërkon hulumtim të thelluar me një shtrirje të gjërë.

²⁶ Ligji Penal i Federatës së B e H; dhe Ligji Penal i Republikës serbe (SG.br.49/2003);

²⁷ Srzentić, Nikola, "Komentar kривичног Закона Србије, SAP Косово и SAP Водојед", Београд, 1981, fq.479;

KAPITULLI – II

2. VEPRAT PENALE TË GRABITJES DHE VJEDHJES GRABITQARE SIPAS KODIT PENAL TË KOSOVËS 2003

2.1 Llojet e veprave penale kundër pasurisë.

Kodi Penal i Kosovës i vitit 2003, veprat penale kundër pasurisë i përfshin në kapitullin XXIII të pjesës së posaqme. Me aprovin e këtij Kodi ka filluar një epokë e re në zhvillimin e të drejtës penale në Kosovën e lirë, të pavarur dhe sovrane. Dispozitat e parapara në këtë kapitull të Kodit Penal, përbajnjë norma të cilat kanë karakter konstituiv. Këto norma të cilat burojnë nga rregullat e karakterit konstituiv, kanë dy elemente përbërëse: *dispositivi* (nacioni dhe elementet e veprës penale) dhe sanksioni (lloji dhe lartësia e dënimit).

Veprat penale kundër pasurisë mund të sistemohen sipas motivit të kryerjes së tyre:

1. Veprat penale të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme;
2. Veprat penale të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme;
3. Veprat penale të cenimit të të drejtave të huaja;
4. Marrja dhe shkatërrimi i sendit të huaj;
5. Veprat penale të keqpërdorimit;
6. Veprat penale të mashtrimit, shantazhit dhe detyrimit.

Ndarja mund të bëhet edhe sipas asaj se kundër kujt bëhet fjalë: sendeve të luajtshme ose pasurisë në përgjithësi. Është e mundur edhe sipas objektit mbrojtës: Sendet e luajtshme dhe kundër të drejtave pronësore dhe të drejtave intelektuale²⁸.

Duke mos përashtuar relevancën e këtyre ndarjeve të veprave penale kundër pasurisë, kapitulli XXIII i Kodit Penal të Kosovës të vitit 2003 specifikon 23 vepra penale:

1. Vepra penale e vjedhjes, neni 252 i KPK-së;
2. Vepra penale e vjedhjes së rëndë, neni 253 i KPK-së;
3. Vepra penale e vjedhjes grabitqare, neni 254 i KPK-së;
4. Vepra penale e grabitjes, neni 255 i KPK-së;
5. Vepra penale – rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes, neni 256 i KPK-së;
6. Vepra penale e shpërdorimit, neni 257 i KPK-së;
7. Vepra penale e marrjes së pasurisë së luajtshme, neni 258 i KPK-së;

²⁸ Salihu Ismet, Hasani Fejzullah dhe Zhitia Hilmi, "Komentari i Kodit Penal i Rep. së Kos. ", Prishtinë, 2014, fq.890;

8. Vepra penale e pushtimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme, neni 259 i KPK-së;
9. Vepra penale – dëmtimi i pasurisë së luajtshme, neni 260 i KPK-së;
10. Vepra penale e mashtrimit, neni 261 i KPK-së;
11. Vepra penale e mashtrimit lidhur me subvencionet, neni 262 i KPK-së;
12. Vepra penale e keqpërdorimit të sigurimit, neni 263 i KPK-së;
13. Vepra penale – hyrja në sistemet kompjuterike, neni 264 i KPK-së;
14. Vepra penale e vjedhjes së imtë, shpërdorimit apo mashtrimit, neni 265 i KPK-së;
15. Vepra penale e lirimit nga dënim, neni 266 i KPK-së;
16. Vepra penale e dëtyrimit, neni 267 i KPK-së;
17. Vepra penale e shantazhit, neni 268 i KPK-së;
18. Vepra penale e keqpërdorimit të besimit, neni 269 i KPK-së;
19. Vepra penale – kontraktimi i përfitimit joproportional, neni 270 i KPK-së;
20. Vepra penale – dëmtimi i të drejtave të personit tjetër, neni 271 i KPK-së;
21. Vepra penale e pranimit të mallrave të vjedhura, neni 272 i KPK-së;
22. Vepra penale – kontrabandimi i mallrave, neni 273 i KPK-së;
23. Vepra penale – krimi i organizuar, neni 274 i KPK-së²⁹.

Tema jonë, veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastet e rënda të këtyre veprave penale i trajton sipas Kodit Penal të Kosovës të vitit 2003 sepse, ka për objekt studimi periudhën 2006 – 2012 , ndërsa ndryshimet e bëra me Kodin e ri Penal të Kosovës – 2012 do të konstatohen dhe vlerësohen. Këto vepra penale kanë elementet e tyre të vecanta dhe karakteristikat sipas të cilave dallojnë nga njëra tjetra. Çdo vepër penale nga ky kapitull dallon sipas mënyrës së kryerjes, formës së kryerjes, mjetit të kryerjes, numrit të personave që kanë kryer veprën penale, etj.

Në tetor të këtij viti është aprovuar Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës (Ligji NR. 04/L-129, dt.19 tetor 2012), sipas të cilit veprat penale kundër pasurisë trajtohen në kapitullin XXVII dhe përfshinë 22 vepra penale. Nga grupi i veprave penale kundër pasurisë të parapara me KPK-në e vitit 2003, me Kodin e ri Penal janë hequr: vepra penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes e paraparë me nenin 256; vepra penale e lirimit nga dënim i paraparë me nenin 266; dhe vepra penale e krimit të organizuar e paraparë me nenin 274 të KPK-së (është bartur në kapitullin e vecantë), ndërsa janë sanksionuar këto vepra penale: vepra penale e vjedhjes së shërbimeve e paraparë me nenin 326; vepra penale e zjarrvënieve nga neni 334; dhe vepra penale e mashtrimit lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Evropian. Duke qenë se sferë e interesit tonë janë veprat penale kundër pasurisë, me aksent të posaçëm në veprat penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, ne nuk do të ndalemi në ndryshime tjera. Me këtë rast do të korrespondon me faktin se elementet e saj janë vendosur në veprat penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, për të cilat do të elaborojmë në këtë kapitull të këtij punimi³⁰.

Konsiderojmë se ndryshimet e bëra përkitazi me rastet e rënda të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes janë qëlluar dhe me vend, sepse, me Kodin e vjetër penal, trajtat e cilësuara

²⁹ Kodi Penal i Kosovës, 2003, Prishtinë, fq.263-270;

³⁰ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012, Prishtinë (Ligji NR. 04/L-129, dt.19 tetor 2012);

të këtyre veprave penale sanksionoheshin me dispozita të veçanta, që nuk ishte racionale. Edhe praktika gjyqësore dëshmon se trajtimi gjyqësor i këtyre rasteve ishte paksa më i ndërlikuar, sepse, ndonëse ishte fjala për të njëjtat vepra penale por në trajtën e cilësuar, sanksionimi ishte i veçantë, gjë që sillte paqartësi të zbatuesit e Ligjit³¹.

2.2 Karakteristikat themelore të veprave penale kundër pasurisë

Vepra penale është nocion themelore dhe i përgjithshem i të drejtës penale. Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si veper penale, tiparët e së cilës janë të përcaktuar me ligj dhe për të cilën me ligj është paraparë sanksioni penal apo masa e trajtimit të dëtyrueshëm³².

Nga nocioni i cituar i veprës penale rrjedhë se ajo rezulton nga sjellja e rrezikshme e personit të caktuar, me të cilën shkaktohet pasojë – dëmi ndaj vlerave të caktuar të cilat mbrohen nga sistemi juridik i shtetit të caktuar.

Objekti mbrojtës i veprave penale kundër pasurisë është e drejta në pasuri, si e drejte themelore universale e të drejtave të njeriut të garantuara me nenin 46 të Kushtëtutes së Kosovës³³.

Karakteristikat themelore të veprave penale kundër pasurisë janë:

- Lloji i pasojës (pasoja paraqitet në trjatë dëmi dhe ky dëm mund të shprehet në të holla);
- Motivi i kryrjes (përvetësimi i kundërligjshem i dobisë pasurore);
- Dashja (këto vepra penale kryhen vetem me dashje direkte);
- Dënimet (për kryesit e këtyre veprave penale parashihet dënim me burgim dhe me gjobë);
- Masoviteti (tendenca permanente e rritjes së këtyre veprave penale);
- Manifestimi (kryesit janë anonim);
- Recidivizmi i kriminelëve (kryesit e këtyre veprave penale, në të shumtën e rasteve janë përseritës të veprave penale);
- Specializimi i kriminelëve (modus operandi);
- Organizimi i kryesve (...në grupe – banda...);
- Dinamika e kryrjes së këtyre veprave penale; dhe
- Përshtatja e kryesve të këtyre veprave penale ndaj kushteve shoqërore.

³¹ Në rrafshin penal, zbatues të Ligjit janë: Policia, Prokuroria dhe Gjyqësori, të cilët ushtrojnë kompetencat e tyre sipas Kushtetutës, KPK-së, KPPK-së si dhe në bazë të Ligjeve përkatëse për Gjykatat, Prokurorin e shtetit dhe Policinë;

³² Neni 6 i Kodit Penal të Kosovës, Prishtinë, 2003;

³³ Neni 46 i Kushtëtutes së Kosovës, Prishtinë, 2008;

2.3 Vepra penale e vjedhjes grabitqare.

2.3.1 Nocioni, përkufizimi, veprimi i kryerjes, kryesi dhe viktima te vepra penale e vjedhjes grabitqare

N o c i o n i – vepra penale e vjedhjes grabitqare është vepër e përbërë penale e cila përbëhet nga vepra penale e vjedhjes (...trajtë e zakonshme e vjedhjes...) dhe nga vepra penale e dhunës (forcës) apo kanosjes. Në këtë kontekst, në përcaktimin e nocionit të veprës penale të vjedhjes grabitqare lartësia e vlerës së sendit të vjedhur dhe shkaku i përdorimit të forcës (shembull: veprimi i pronarit të sendit për kthimin e sendit), nuk janë relevante.

Zbërthimi i nocionit të veprës penale të vjedhjes grabitqare, nxjerrë në pah këto elemente të saj:

- Vjedhja grabitqare fillon me kryerjen e vjedhjes;
- Kryesi i vjedhjes duhet të përdorë (dhunën) forcën për ta mbajt sendin e vjedhur;
- Kryesi duhet që, forcën ta përdorë derisa është i zënë në veprën e vjedhjes; dhe
- Vepra penale e vjedhjes grabitqare është kryer kur pas vjedhjes së kryer përdoret dhuna apo kanosja për ta mbajtur sendin.

Përkufizimi i veprës penale të vjedhjes grabitqare – kushdo që i zënë në befasi në kryerjen e aktit të vjedhjes dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbaj, e përdor dhunën (forcën) apo kanosjen se do të sulmojë jetën apo trupin e personit tjetër kryen veprën penale të vjedhjes grabitqare.

Sipas Kodit Penal të Kosovës – 2012, vepra penale e vjedhjes grabitqare e inkriminuar me nenin 328, është plotësuar edhe me dy paragrafe në të cilat janë të përfshirë rastet e vjedhjes grabitqare të cilat kanë përfunduar me lëndim të rëndë trupor apo me vdekje³⁴.

Element themelore i kësaj vepre penale është përdorimi i dhunës apo kanosjes me qëllim të mbajtjes së sendit paraprakisht të vjedhur. Nëse kjo nuk është esenca e përdorimit të dhunës apo kanosjes nuk ka vepër penale të vjedhjes grabitqare, por ekziston bashkimi i veprës penale të vjedhjes së rëndomtë ose të rëndë dhe ndonjë vepër tjetër penale e cila në vete përmban elemente të dhunës (forcës) apo kanosjes³⁵.

Elementet e cekura më lartë në mënyrë strikte përkufizojnë ekzistimin e veprës penale të vjedhjes grabitqare. Përbushja e elementeve të veprës penale të vjedhjes grabitare përjashton mundësin e

³⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Ligji NR. 04/L-129, dt.19 tetor 2012);

Komenti i dispozitave të nenit 328 të KPK-së: sipas nenit 328 par.3, kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 7 deri 12 vjet. Paragrafi 4 i këtij neni parashev rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekje, kryesi dënohet me gjobë dhe burgim së paku 10 vjet ose me burgim të përjetshëm.

³⁵ Rasti, kur përdorimi i forcës nuk është në funksion të mbajtjes së sendit i cili paraqet element themelore të veprës penale të vjedhjes grabitqare, është, edhe: nëse kryesi sendin e vjedhur e ka fshehur, e ndaj personit i cili kërkon sendin e përdor forcën, nuk ekziston vepra penale e vjedhjes grabitqare, por bashkim i vepres penale të vjedhjes nga neni 252 të KPK-së dhe dëtyrimi nga neni 267 të KPK-së.

konstrukcionit të veprës penale të vazhduar, përveç, nëse është kryer me shfrytëzimin e rastit të njejtë ndaj më shumë të dëmtuarve.

Veprimi i kryerjes – së kësaj vepre penale konsiderohet përdorimi i dhunës (forcës) apo kanosjes së drejtpërdrejt ndaj jetës dhe trupit të personit, me qëllim të mbajtjes së sendit të vjedhur. Natyrisht, përdorimi i dhunës apo kanosjes, domosdo nuk duhet të jetë e drejtuar ndaj pronarit nga i cili merret sendi³⁶.

Objekti mbrojtës i veprës penale të vjedhjes grabitqare është pasuria, ndërsa objekt i sulmit është sendi i huaj i luajtshëm. Është më rëndësi se fjala është për sendin e luajtshëm i cili paraqet lëndë të natyres materiale, i cili mund të lëvizet, transferohet ose ndahet nga sendi kryesor e që në atë moment mos të ndryshoj tiparet e substancës.

Kryesi – i vjedhjes grabitqare përdorë dhunën (forcën) apo kanosjen ndaj personit i cili e ka takuar në aktin e kryerjes së vjedhjes. Veprimi i kryerjes konsiston në përdorimin e dhunës, e më qëllim të posedimit të mëtejshmë të sendit³⁷, dmth, forca duhet të jetë e tillë, që shikuar objektivisht duhet të jetë e mjaftueshme të eliminoi kundërvënien e pronarit, e që nënkupton se vjedhja ka qenë e kryer, gjegjësisht, kryesi është zënë në vjedhje. Kanosja nënkupton vënien në pah të faktit se drejtpërdrejt do të sulmohet jeta ose trupi i personit. Ky rrezik i kanosur duhet të jetë i njëkohëshëm, serioz dhe i mundshëm. Konsiderohet se kryesi i vjedhjes mund të kryej vjedhjen grabitqare, gjithnjë, deri sa nuk e zotëron në mënyrë të qetë dhe të sigurt sendin e vjedhur (shembull: nëse kryesi i vjedhes gjindet në arrati me sendin e marrur nga viktima). Mirëpo, kjo vepër është kryer në momentin kur është kryer akti i dhunës apo kanosjes, pavarësisht nga fakti se kryesi a ka arritur të mbaj sendin në posedim³⁸. Kryesi i vjedhjes grabitqare mund të jetë vetem person i cili ka kryer vjedhjen dhe i cili gjithmonë vpron me dashje. Kryes i vjedhjes grabitqare mund të jetë edhe bashkëkryesi në vjedhje, ashtu që ai me ndonjë veprim pengon tjetrin në pengimin e bashkëkryesit në mbajtjen e sendit i cili është vjedhur me veprimin e tyre të përbashkët.

Viktima – është çdo person ndaj të cililit mund të përdoret dhuna apo kanosja. Këto mjete përdoren ndaj të cililit çdo person i cili pengon kryesin e veprës penale të vjedhjes që sendin e vjedhur ta merr me vete (...rasti, kur kryesi i vjedhjes me sendin e vjedhur iken nga vendi i ngjarjes dhe në rrugë e sipër pengohet nga ndonjë person tjetër...).

³⁶

.Jovašević, D. Časopis Bezbednost – 2/2005, Beograd, 2005, fq.252;
Dhuna apo kanosja mund të përdoret edhe ndaj personit i cili ka posedim momental sendin e huaj, shembull:
kalimtari i rastit i cili e pengon kryesin e vperës penale që të marrë sendin e huaj.

³⁷

Stojanović, Z. Perić, O – “Krivično pravo – posebni deo” Beograd, 2007, fq.147;

³⁸ Srzentić Nikola, “Komentar krivičnog Zakona Srbije, SAP Kosova i SAP Vojvodine”, Beograd, 1981, fq.503;

2.3.2 Format e kryerjes të veprës penale të vjedhjes grabitqare

Praktika e çështjeve të trajtuara nga organet e ndjekjes dhe ato të gjyqësisë tregon se vepra penale e vjedhjes grabitqare kryhet në forma të ndryshme dhe karakterizohet me perdorimin e forcës fizike apo mekanike me qëllim të mbajtjes së sendit të vjedhur. Si kemi thënë më parë, kjo vepër është “vazhdim” i veprës penale të vjedhjes, dhe pikërisht duke patur parasysh këtë fakt, dhe format e kryerjes së kësaj vepre penale dallojnë nga vepra penale e grabitjes.

Trajtat më të shpeshta të kryerjes së vjedhjes grabitqare janë:

2.3.2.1 Vjedhja grabitqare e kryer ndaj personit të rastit

Në territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, për kundër faktit se në periudhën: 2008 – 2012 nuk është shënuar ndonjë rast i vjedhjes grabitqare të kryer ndaj personave të rastit, kjo formë e kryerjes është e njohur. Kjo formë e kryerjes së vjedhjes grabitqare kryhet zakonisht në rrugë të pandriquara, në hyrje të shtëpive – banesav etj.

2.3.2.2 Vjedhja grabitqare e kryer me hyrje në shtëpi–banesë ose lokal afarist.

Kjo formë e kryerjes së veprës penale të vjedhjes grabitqare zakonisht kryhet me përdorimin e forcës fizike apo mjeteve tjera të rrezikshme në çastin e kryerjes se vepres penale. Kjo vepër penale kryhet nga individi si dhe në grup. Në territorin e Qarkut të Pejës dhe Gjykatës Themelore të Gjakovës në periudhen: 2006 – 2012, vepra penale e vjedhjes grabitqare e kryer me hyrjen në shtëpi – banesë apo lokal afarist është kryer gjithsej në një rast.

2.3.2.3 Vjedhja grabitqare e kryer me armë dhe nga më shumë persona

Kur kryesi i veprës penale kryen një vjedhje me thyerje, e pastaj edhe një tjetër, dhe me atë rast kapet, atëherë, duke dashur që ti mbaj sendet e vjedhura me këto dy vepra penale, me revole kërcënë personin i cili ka tentuar ta pengoj kryesin që t'i bartë sendet – ai kryen vepër penale të vjedhjes grabitqare. Kjo vepër penale ekziston edhe kur kryesi përkundër përdorimit të forcës nuk arrin ta mbaj sendin e luajtshëm të vjedhur.

Nëse në vjedhje marrin pjesë dy ose më shumë persona, atëher ekziston vepra penale e vjedhjes grabitqare e kryer nga më shumë persona, pavarësisht nga fakti se nuk ka pas marrëveshje paraprake, pasi ajo ka ekzistuar heshtazi. Në territorin e Qarkut të Pejës dhe Gjykatës Themelore

të Gjakovës, në periudhen shqyrtyuese nuk shenohet ndonjë rast i veprës penale të vjedhjes grabitqare të kryer në këtë formë. Mirëpo, vite më parë kemi pas raste të tilla. Përndryshe, praktika gjyqësore në territorin e Qarkut të Pejës, shënon rastet më të shpeshta të kryera të grabitjes me armë dhe nga më shumë persona. Kjo, për arsy se, periudha e sanimit të pasojave të luftës; papunësia e madhe; numri enormë i armëve pa leje; si dhe shumë faktor tjerë të natyrës socio-ekonomike dhe regionale kanë shkaktuar çrregullime të shumta në jetën e njerëzve në Kosovë.

2.4 Vepra penale e grabitjes

2.4.1 Nacioni, përkufizimi, veprimi i kryerjes, kryesi dhe viktima te vepra penale e grabitjes.

N o c i o n i – vepra penale e grabitjes nënkupton përdorimin e dhunës (forcës) ose kanosjes ndaj ndonjë personi më qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të sendit të huaj të luajtshëm. Duke qenë se grabitja posedon elementin e dhunës, ajo rënditet në kategorin e kriminalitetit të dhunshëm. Konstrukcioni juridik i veprës penale të grabitjes këtë vepër e ofron me veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të qytetarit, e edhe me veprat penale kundër jetës dhe trupit.

Zbërthimi i npcionit të veprës penale të grabitjes nga neni 255 i KPK-së nxjerrë në pah këto elemente të saj:

- Përdorimi i dhunës ose kanosjes (...se drejtpërdrejt do të sulmoj jetën apo trupin...) i paraprin kryerjes së vjedhjes;
- Dhuna, gjegjësish kanosja duhet të përdoret ndaj personit i cili është në posedim të sendit apo i cili realisht do të pengoj kryesin e veprës në realizimin e qëllimit të tij përmarrjen e sendit; dhe
- Grabitja është e kryer kur me përdorimin e dhunës ose kanosjes është e kryer vepra e vjedhjes.

Përkufizimi i veprës penale të grabitjes – kushdo që e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që t'i sjellë vetit apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdorur dhunën apo kanosjen kundër personit tjetër se do ta sulmoj atë çast jetën ose trupin e personit tjetër, kryen veprën penale të grabitjes. Elementet e paraqitura korrespondojnë me *veprën penale të përfunduar të grabitjes*, dhe në këtë rast kryesi përgjigjet për veprën e kryer penale. Për shkak të rrethanave të caktuara këto raste shpesh nuk përfundojnë, respektivisht, ngelin në *tentativë*, ose nuk përfundojnë për shkak të *heqjes dorë vullnetare* nga kryesi i vperave penale. Sipas dispozitave të Kodit të ri Penal të Kosovës, vepra penale e grabitjes e inkriminuar me nenin 329, është plotësuar edhe me 2 paragraf në të cilët janë të përfshirë rastet e grabitjes të cilat kanë përfunduar me lëndim të rëndë trupor apo me vdekje.

Veprimi i kryerjes – së kësaj vepre penale konsiderohet marrja e sendit të huaj të luajtshëm me përdorimin e dhunës apo kanosjes së drejtpërdrejt ndaj jetës dhe trupit të personit. Natyrisht, përdorimi i dhunës apo kanojes, domosdø nuk duhet të jetë i drejtuar ndaj personit nga i cili merret sendi (...mund të kanoset edhe personi te i cili momentalisht gjendet sendi, etj...).

Përdorimi i dhunës (forcës) nënkupton përdorimin e forcës trupore apo mekanike. Sipas intensitetit, forca mund të jetë *absolute* (vis apsoluta) ose *kompulsive* (vis kompulsiva – dëtyrimi psikik). Këtu duhet dalluar rastin e “nxerrjes së sendit nga dora”, kur bëhet fjal për vjedhje të rëndë. Mjafton që forca të përdoret ashtu që viktima të mos ketë mundesi të kundërvihet marrjes së sendit (shembull: viktima – i sulmuari është i myllur). Sipas rregullit të grabitja forca përdoret për të penguar kundërvënien, mirëpo, përdoret edhe për pengimin e kundërvënieς e cila pritet me kryerjen e vjedhjes.

Kanosja duhet të jetë serioze, dhe te grabitja kjo vlerësohet sipas asaj se objektivisht a ka krijuar bindje se do të realizohet, dhe me atë rast nuk është relevante se kryesi a ka pasë qëllim ta realizoj kanosjen. Në këtë rast kanosja në kuptim të kësaj vepre penale nuk është relevante, se kryesi a ka pasur qëllim ta realizoj kanosjen, apo a ka pasur kundërvënie nga i dëmtuari. Kështu, sipas një vendimi të GJSS –Kž.br.674/68, do të ekzistoj grabitja edhe nëse i dëmtuari duke qenë i kanosur, ai ka dorëzuar portofolin³⁹.

Edhe nëse me revole fals (plastike, apo me gaz) e cila duket si revole e vërtet, me të cilën kryesi kanos të dëmtuarin se do ta sulmoj jetën dhe trupin e tij, paraqet mjet të përshtatshem për marrjen e sendit të huaj të luajtshëm – kryerjen e veprës penale të grabitjes. Pra për ekzistimin e veprës penale të grabitjes nuk është me rëndësi se kryesi i veprës a është shërbyer me revole të vërtet apo me gaz, sepse, është e pakontestueshme se kryesi duke kërcënuar me revole (si mjet detyrimi) ka shkaktuar te i dëmtuari frikë për jetën dhe trupin e tij.

Analiza kohore e ndërmarrjes së veprimeve të kryerjes te vepra penale e grabitjes vënë në pah se kjo është vepër penale e përbërë për ekzistimin e së cilës nevojitet ndërmarrja kumulative e dy veprimeve (përdorimi i forcës dhe marrja e sendit të huaj të luajtshëm), dhe se në mes të këtyre dy veprimeve nuk bënë të ketë distancë kohore më të gjatë.

Praktika bashkëkohore dëshmon se forcë (...forma dëtyrimit...) konsiderohet jo vetëm forca fizike por edhe përdorimi i mjetëve me veprim akut (spreji nga i cili momentalisht përsoni humb të pamurit); kontakti i hundës me etër; si dhe përdorimi i tabletave me pije. Të gjitha këto forma konsiderohen të mjaftuara për ta amortizuar kundërvënien e personit i cili tenton ta pengoj kryesin në mbajtjen e sendit⁴⁰.

Objekti mbrojtës dhe i sulmit nuk dallon nga vepra penale e vjedhjes grabitqare.

Kryes i – i veprës penale të grabitjes mund të jetë personi i cili përdor dhunën – kanosjen ndaj viktimës, e më qëllim të marrjes së sendit të huaj të luajtshëm. Kryes i grabitjes mund të jetë edhe bashkëkryesi, ashtu që ai me ndonjë veprim pengon tjetrin në pengimin e kryesit – bashkëkryesit në mbajtjen e sendit i cili duhet të vëhet në posedim të tyre, ose kur bashkëkryerja realizohet

³⁹ Jovašević, D, Časopis, Bezbednost – 2/2005, Beograd, 2005, fq.254;

⁴⁰ Po aty, fq252-253;

nëpërmjet marrëveshjes, ashtu që derisa në bashkëkryes aplikon dhunën apo kanosjen, tjetri merr sendin.

V i k t i m a – është person i cili bënë përpjekje të pengoi kryesin në marrjen e sendit. Forca zakonisht përdoret ndaj personit nga i cili merret sendi, por, mund të aplikohet edhe ndaj personit tjeter (...rasti kur kryesin e pengon ndonjë person të merrë sendin, shembull: kalimtari i rastit ndihmon viktimin të cilin i merret sendi...). Analiza e grabitjeve vënë në pah faktin se frika e pësuar shkakton vazhdimin e ndjenjës së pasigurisë, dhe pasojat janë të ndryshme.

2.4.2 Format e kryerjes të veprës penale të grabitjes

Legjislacioni ynë penal në kuadër të veprave penale kundër pasurisë trajton edhe vepren penale të grabitjes, dhe sankionon format e saj të paraqitjes. Kështu. Kodi Penal i viti 2003 si dhe Kodi Penal aktual i Kosovës parashohin përafërsisht trajtat e njëjtë të paraqitjes së kësaj vepre penale. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se me Kodin e ri Penal të Kosovës rastet e rënda të grabitjes janë inkorporuar në dispozitat e nenit i cili sanksionon vepren penale të grabitjes (...neni 329 i KPK-së...), respektivisht, me këtë dispozitë ligjore janë përfshirë të gjitha format e paraqitjes së veprës penale të grabitjes.

Bazuar në faktin se, të dy Kodet Penale të Kosovës në mënyrë gati identike trajtojnë paraqitjen e vepres penale të grabitjes, rrjedhë se, sipas dispozitave të nenit 255 -256 të KPK-së se vitit 2003 dhe të dispozitave të nenit 329 të KPK-së së vitit 2012, format kryesore të paraqitjes së vepres penale të grabijtes janë:

- Forma themelore (neni 255 par.1 i KPK-së se vitit 2003, ndërsa neni 329, par.1 i KPK-së së vitit 2012);
- Forma e rëndë (neni 255 par.2, 3 dhe par.1 i nenit 256 të KPK-së së vitit 2003, ndërsa neni 329 par.2, 3 dhe 4 i KPK-së së vitit 2012); dhe

Forma më e rëndë (neni 256 par.2 i KPK-së, ndërsa neni 329 par.5 i KPK-së i vitit 2012)

Mbështetur në të dhënat statistikore të organeve të ndjekjes, vepra penale e grabitjes kryhet në forma të dryshme dhe karakterizohet në veçanti me përdorimin e forcës fizike apo mekanike, e në këtë kontekst janë të shpeshta kërcënimi apo përdorimi i armëve të zjarrit.

2.4.2.1 Grabitja e kryer ndaj personit të rastit

Kjo formë e kryerjes së vepres penale të grabitjes është pothuajse trajta më e shpeshtë, sepse, kjo mundësi kryesit (...i cili nuk është fillestar...) i paraqitet pa ndonjë planifikim dhe përgatitje paraprake. Këtë fakt e vërtetojnë rastet e kryera të grabitjes në përgjithësi, e në veçanti ato te kryera në territorin e Qarkut të Pejës. Në territorin e Qarkut të Pejës në periudhen: 2006 – 2012, kjo formë e kryerjes së veprës penale të grabitjes është prezente.

Objekti i veprës penale nuk është specifik, respektivisht, mund të jenë të gjitha kategoritë e personave të rastit.

2.4.2.2 Grabitja e kryer në pusi

Kryerja e veprës penale të grabitjes në pusi është trajtë e kryerjes e cila kërkon ndërmarrjen e veprimeve paraprake përkitazi me objektin e vperës penale, lëvizjet e tij, si dhe shumë informacione tjera të cilat ia lehtësojnë kryesit të veprës penale kryerjen me “sukses” të grabitjes (...përvetësimi i sendeve – vlerave dhe largimi nga vendi i ngjarjes pa lënë gjurmë të veprës së kryer...). Lidhur me këtë formë të kryerjes së vepres penale të grabitjes, do të paraqesim rastin penal të shqyrtuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë, të grabitjes së kryer në pusi, i cili ka përfunduar me aktgjykimin P.nr.327/09 dt.15.12.2009, ashtu që të akuzuarit A.SH. dhe K.N. janë shpallur fajtor dhe gjykuar me burgim në kohëzgjatje me nga dy vite.

2.4.2.3 Grabitja e kryer në bazë të shoqërimit paraprak me viktimin

Nuk janë të rralla rastet kur veprës penale të grabitjes i paraprin njohja, respektivisht shoqërimi me viktimin. Njohja, gjegjësisht shoqërimi mundëson marrjen e informacioneve të duhura për viktimin, objektin e tij të banimit, gjendjen e tij pasurore etj, e të cilat lehtësojnë kryerjen me sukses të veprës penale. Natyrisht, ka raste kur përkundër këtyre njohurive paraprake, gjatë kryerjes së veprës penale, situata komplikohet për çfarë kryesi i veprës penale ndërmerr edhe veprime të paplanifikuara mirë të cilat vështirësojnë pozitën e tij. Kështu, në praktiken gjyqësore në Gjykatën e Qarkut të Pejës është shqyrtuar çështja penale P.nr.210/11, dhe ka përfunduar me aktgjykim gjykuar, ashtu që i akuzuari S.D. është shpallur fajtorë për veprën penale të grabitjes nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe është dënuar me 2 (dy) vite e 3 (tre) muaj burgim. Në procedurën ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin AP.nr.363/11 dt.04.01.2012, e ka vërtetuar aktgjykimin e goditur.

2.4.2.4 Grabitja e kryer me hyrjen në shtëpi – banesë

Kjo formë e kryerjes së veprës penale të grabitjes në shoqërit bashkëkohore është e shpeshtë, dhe zakonisht kryhet me përdorimin e armëve të zjarrit apo mjeteve tjera të rrezikshme, si dhe në grupe e më rrallë vetëm. Në territorin e Gjykates së Qarkut të Pejës në periudhen: 2006-2012, vepra penale e grabitjes me hyrje në shtëpi – banesë është e shprehur më shpesh se format tjera të kryerjes. Në mesin e veprave penale të grabitjes të kryera me hyrje në shtëpi – banesë ne do të paraqesim rastin penal të shqyrtuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë, i cili ka përfunduar me aktgjykimin P.nr.433/07, dt.06.07.2—7, ashtu që i akuzuari I.I. është shpallur fajtor dhe gjykuar me burgim në kohëzgjatje prej tre vite.

2.4.2.5 Grabitja me vënien e pusisë ndaj inkasantit apo postierit

Kjo formë e kryerjes së veprës penale të grabitjes është identike me formën e kryerjes së grabitjes në pusi të cilën e trajtuam në pikën 2.4.2.2, me dallimin e vetëm se këtu kemi të bëjmë me objektin

specifik të veprës penale. Në këto raste, kryesi i veprës penale paraprakisht vendos të bëjë grabitjen ndaj postierit apo inkasantit të ndonjë ndërrmarrjeje, i cili me vetë disponon shuma të caktuara të parave të cilat i inkason nga qytetarët, apo mund të jenë realizar si pazar ditor i firmës.

2.4.2.6 Grabitja e kryer e armatosur në institucionet financiare-Banka, Postë, KEK

Duke qenë se të shumtën e rasteve, në këto institucione rëndom kryhen vepra penale të grabitjes me tipare të trajtës së cilësuar, kjo formë e grabitjes do të shqyrtohet në pikën për rastet e rënda.

2.4.2.7. Simulimi (Fingimi) i grabitjes

Nocioni i veprave penale të finguara

Ne kuptimin etimologjik, fjala simulim (fingim) nënkuption sajimin e ngjarjes së paqenë. Në rrafshin juridiko-penal, simulimi nënkuption ndërmarrjen e veprimeve të caktuar të kryesve të veprave penale të cilët përpinqen në mënyra të ndryshme të fshehin veprën penale, gjegjësisht, t'i paraqesin të njejtat jo si vepra penale dhe në këtë mënyrë të heqin dyshimin nga vehtja dhe aktivitetin hetimor të policisë ta orientojnë në drejtim tjetër. Kjo dukuri është veçanërisht karakteristike për veprat e rënda penale, në mesin e të cilave hyjnë edhe veprat penale të grabitjes⁴¹

Vlen të theksohet se ngjarjet e finguara janë karakteristike sepse, është fjala për ngjarjet të cilat në të vërtetë nuk janë kriminale. Nëse arrihet fshehja e caktuar e veprës penale (...qëllimi i simulimit të veprës penale është fshehja e veprës së vërtetë penale...), atëherë, kryesi do ta shmang përgjegjësin penale.

Është me interes të thuhet se janë të shumta arsyet e simulimit të veprave penale.

1. Kështu rastet më të shpeshta të veprave penale janë për shkak të *fshehjes së humbjeve së parave* në *bixhoz*, apo *shpenzimi i tyre* për *qëllime tjera* të cilat duhet *fshehur* nga *familjaret etj.* Në literaturë janë të shumta rastet e simulimit të veprave penale të grabitjes për këtë arsy.

Shembulli: përsonit D.K. me 03.11.2008, ka paraqitur në Polici, se atë ditë rreth orës 18:00, në rrugën A.F. e kanë takuar 3 persona dhe nën kërcënëm me revole i kanë marrë 45,00 €. Pas aktivitetit operativ, Policia ka zbuluar se grabitja ndaj personit D.K. nuk është kryer fare, për çfarë, në Prokurorinë kompetente është inicuar procedura penale ndaj këtij personi për shkak të kallëzimit të rremë.

2. Në shoqërinë bashkëkohore nuk janë të rralla edhe rastet kur të moshuarit *për shkak* të *vetmisë së tyre* (...nuk vizitohen nga femijët e tyre...) simulojnë rastet e grabitjës.

⁴¹ Vesel Latifi, "Kriminalistika" Prishtinë, 2000, fq.122-123;

Shembull: plaka K.M. lajmron Policinë se dy persona e kanë sulmuar dhe rrahur, dhe marrë orën e dorës dhe nji bylyzyk. Pas punës operative, Policia ka vërtetuar se thënjet e saj janë të sajvara, dhe se plaka lëndimet i'a ka shkaktuar vetes.

3. Kohët e fundit janë prezente simulimi i veprës penale të grabitjes *për shak të mungesës së paraqitur në arkë të Bankës*.

Shembull: M.P. dhe S.P. dhe dy zyrtar nga trezori i Bankës “Marfin” kanë tërheq nga arka pa bazë 160.000,00 €, kështu që për të fshehur mungesën janë marrë vesh me personin P.V. të kryej grabitjen e simuluar. Kështu, me 15.12.2012, ai ka thyer xhamin e “Marfin Bankës”, dhe nëpërmjet kryerjes së krijuar me thyerje ka futur dorën e tij me të cilin ka drejtuar revolen e plastikës ndaj personit S.P., të cilit me ton të ngritur i ka kërkuar parat, të cilat ai “sipas marrëveshjes paraprake” i'a jap kovertën e bardhë të zbrazët, pas së cilës e lajmron rastin e grabitjes në Polici. Veprimet e ndërmarrura operative të Policisë vërtetojnë se bëhet fjalë për rastin e finguar të grabitjes, e më qëllim të fshehjes së veprës penale të keqpërdorimit të dëtyrës zyrtare dhe veprave tjera penale⁴².

2.5 Rastet e rënda të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes

Sipas legjislacionit penal të aplikueshëm për periudhën 2006 -2012, veprat penale të vjedhjes grabitqare dhe të grabitjes marrin trajtë të cilësuar – të rëndë (subkualifikimi për të cilin Ligji parashikon dëname më të ashpra) nëse është shkaktuar pasoja më e rëndë si rezultat i dashjes, ose nëse vepra themelore është kryer në rrethana posaçërisht të kualifikuara.

Në legjislacionin penal të pasluftës së dytë botërore të Jugosllavisë këtyre veprave penale i janë atribuar rastet e grabitjes dhe vjedhjes grabitqare të cilat:

1. Janë kryer në mënyrë mizore, ose gjatë kryerjes së tyre është shkaktuar te viktima lëndim i rëndë trupor ose është privuar ngajeta; dhe
2. Janë kryer në atë mënyrë që te viktima kanë shkaktuar dhëmbje fizike ose shpirtërore⁴³.

Aktualisht, në regionin tonë mbizotëron koncepti sipas të cilit këto vepra penale (...vjedhja grabitqare dhe grabitja...) kanë tri trajta të paraqitjes, dhe atë:

1. Nëse me rastin e kryerjes së këtyre veprave penale ndonji personi me dashje i shkaktohet lëndim i rëndë trupor;
2. Nëse trajta themelore e veprës penale kryhet nga ana e grüpuit - bandës; dhe
3. Nëse gjatë kryerjes së veprave penale, me dashje personi i caktuar privohet ngajeta.

⁴²Raste prej 1 – 3 kanë ndodhur në territorin e Malit të Zi dhe Sërbisë dhe janë nxjerrë nga sajtet: ee.e.rtv.rs/sr-lat/hronika dhe ee.e.nezavisne.com/novosti/hronika;

⁴³ Tahović Janko, “Komentari krivičnog zakonika” Beograd, 1956, fq.495;

Dukë qenë se vepra penale e cilësuar e grabitjes apo vjedhjes grabitqare në trajtën e lëndimit të rëndë trupor është forma më e shpeshtë e cila paraqitet në praktikën gjyqësore, ne do ta trajtojmë në veçanti.

Vepra e cilësuar në trajtën e **lëndimit të rëndë trupor** ekziston nëse në mënyrë kumulative përbushën këto kushtë:

- Gjatë kryerjes së veprës penale të vjedhjes grabitqare apo grabitjes një personi i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor; dhe
- Lëndimi i rëndë trupor është rezultat i dashjes së kryesit të veprës penale.

In conreto

Rasti i rëndë i grabitjes do të jetë i kryer, nëse me dashje i shkaktohet viktimës lëndim i rëndë trupor, edhe nëse vepra e grabitjes mbetet në tentativë (...nëse sendi nuk është marrur...).

Nëse gjatë kryerjes së lëndimit të rëndë trupor te i akuzuari është formuar dashja, e më qëllim të marrjes së parave, për çfarë përdorimi i mëtejmë i forcës ndaj të dëmtuarit ka qenë në funksion të marrjes së parave, atëherë kemi vepër penale të rasteve të rënda të grabitjes. Nëse në raport me lëndimin e rëndë trupor ka ekzistuar pakujdesia e kryesit, atëherë nuk do të kemi vepër penale të grabitjes, por do të ketë bashkim të trajtës themelore të grabitjes dhe lëndimit të rëndë trupor nga pakujdesia. I njejti kriter vlen edhe me rastin e vlerësimit të ekzistimit apo mosekzistimit të veprës penale të rastit të rëndë të vjedhjes grabitqare, duke respektuar qenien e veprës penale të vjedhjes garbitqare.

Në praktiken juridike, shënohen rastet kur me përdorimin e dhunës (forcës) gjatë kryerjes së vjedhjes grabitqare apo grabitjes mund të realizohen tiparet e ndonjë vepër tjetër penale kundër jetës dhe trupit. Në këto raste shtrohet pyetja, a ekziston bashkimi i veprave të realizuara penale apo është fjala për format e rënda të grabitjes gjegjësisht, vjedhjes grabitqare? Këtë problem Kodi Penal i Kosovës i vitit 2003 e rregullon me dispozitat e nenit 256, ashtu që i përcakton rastet e rënda të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, dhe atë në dy raste:

- nëse kryerja e vjedhjes grabitqare apo grabitjes rezulton me lëndim të rëndë trupor ose është kryer nga një grup i armatosur, përdor armë apo mjet i rrezikshëm – kryesi dënohet më së paku 5 vjet burgim; dhe
- nëse kryerja e vjedhjes grabitqare apo grabitjes rezulton me privim ngajeta e personit më qëllim – kryesi dënohet me së paku 10 vjet burgim apo burgim afatgjatë.

Kodi Penal i ri i Kosovës format e rënda të veprës penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes i sanksionon me dispozitat e nenit 328 dhe 329 me të cilat parashihen vepra penale e vjedhjes grabitqare dhe grabitjes, ashtu që për trajten e këtyre veprave penale të cilat rezultojnë me lëndim të rëndë trupor parashihet dënim prej 7 deri 12 vjet, ndërsa për rastet me pasoja të vdekjes parashihet dënim me burgim së paku 10 vjet ose burgim të përjetshëm.

Lëndimi trupor apo vrasja, domosdo nuk duhet t'i jenë shkaktuar personit nga i cili merret sendi, ose i është marrë sendi. Personi i privuar ngajeta apo i lënduar mund të jetë çdo person tjeter i cili në çfarëdo mënyre ka marrë pjesë në pengimin e kryesit në vjedhje apo grabitje, në përfundimin e marrjes së sendit me përdorimin forcës⁴⁴.

Mbështetur në të theksuarat, nëse plotësohen kushtet e caktuara më lartë, atëherë është i pamundur bashkimi në mes këtyre veprave penale dhe vrasjes, gjegjësisht, lëndimit të rëndë, prandaj është i pakuptim që elementi kualifikues të sanksionohet dy herë. Në këtë konstelacion të veprimeve të cilat inkriminojnë veprimet e kryesit të veprës penale, përfshirë fajësin mjaftron pakujdesia e tij.

Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës i miratuar në tetor të vitit 2012 (Ligji NR. 04/L-129, dt.19 tetor 2012), veprat penale kundër pasurisë i trajton në kapitullin XXVII, dhe nga ky grup i veprave penale janë hequr: vepra penale, rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes e parapar me nenin 256 të Kodit Penal të mëparshëm të Kosovës. Këto raste të veprave penale janë përfshirë në përbajtjen e veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare të inkriminuar në dispozitat e nenit 328 dhe 329 të KPK-së. Sipas ndryshimeve të KPK-së, vepra penale e vjedhjes grabitqare dhe grabitjes (e inkriminuar me nenin 328 dhe 329 të KPK-së), është plotësuar edhe me dy paragrafe në të cilët janë përfshirë rastet e cilësuara të këtyre veprave penale të cilat kanë përfunduar me lëndim të rëndë trupor apo me vdekje. Nga këndveshtrimi juridiko – penal (teorik) dhe praktikë (...gjyqësori...) këto ndryshime janë padyshim kualitative, sepse, thjeshtësojnë inkriminimin, përfshijnë të gjitha aspektet e formave të kryerjes së këtyre veprave penale, si dhe lehtësojnë aplikimin e këtyre dispozitave ligjore në praktik. Natyrisht, duhet pritur të kaloj një kohë, gjegjësisht, të procedohen rastet e cilësuara të këtyre veprave penale e pastaj të nxjerrën përfundime ekzakte.

2.5.1 Përgjegjësia penale e bashkëkryesve për rastet e rënda të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes.

Vepra penale e vjedhjes grabitqare dhe grabitjes, gjegjësisht, rastet e tyre të cilësuara mund të kryhen nga një apo më shumë përsone. Kur këto vepra penale kryhen nga më shumë persona kemi të bëjmë me format e ndryshme të *bashkëpunimit* në kryerjen e veprës penale. Kështu ata mund të ndajnë rolet e tyre, dhe këtu kemi të bëjmë me *bashkëkryerje*. Dispozitat e nenit 256 në par.1, të KPK-së, parashohin rastet kur vepra penale është kryer nga një grup i personave të armatosur, dhe në këto raste, shtrohet çështja e përcaktimit të përgjegjësis penale të tyre në cilësi të bashkëkryesve. Kur flitet për “grupin e armatosur” kemi parasysh organizimin e quajtur bandë apo grup, e të cilat paraqesin bashkim të më shumë personave.

Banda konsiderohet bashkim i anëtarëve të saj të cilët në kuptimin organizativ janë të lidhur fortë dhe veprimtaria e tyre është asfatgjatë, përfshirë, veprat penale sipas numrit, kohës dhe mënyrës së kryerjes nuk janë të caktuara. Natyrisht, këto trajta të organizimit kriminal janë shumë të

⁴⁴ Srzentić Nikola, “Komentar krivičnog zakona Srbije, SAP Kosova i SAP Vojvodine”, 1981, Beograd, fq.506;

rrezikshme për sigurin e qytetarëve të cilët jetojnë në vendet ku veprojnë ato. Në kuptimin afatgjatë, edhe siguria e shtetit mund të kërcënohet nga aktiviteti i këtyre bandave, sepse, këto bëjnë përpjekje të pareshtura që të infiltrohen edhe në strukturat – segmentet e caktuara të shtetit.

Kodin Penal të vitit 2003 ka sanksionuar dënimë afatgjate të burgut, ndërsa në Kodin e ri Penal të Kosovës është paraparë edhe dënim i më burgim të përjetshëm, është kur gjatë kryerjes së këtyre veprave penale ndonjë person me dashje **privohet ngajeta**.

Për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale kërkohet përbushja e këtyre kushteve:

- ndërmarrja e veprimit të kryerjes së veprës penale të vjedhjes grabitqare ose grabitjes me përdorimin e forcës, më qëllim të mbajtjes apo marrjes së sendit të huaj të luajtshëm;
- për shkak të përdorimit të forcës është shkaktuar vdekja; dhe
- pasoja e vdekjes, si rezultat i veprimit të kryerjes është përfshirë me dashjen e kryesit. Të privuarit ngajeta e personit në këto raste mund të kryhet edhe me dashje eventuale⁴⁵.

Konsiderohet se, për rastet e rënda të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes penalisht janë përgjegjës të gjithë anëtarët e grupit – bandës, të cilët kanë vepruar në trajtat e ndryshme të bashkëpunimit, e edhe ata të cilët janë pajtuar me ndërmarrjen e veprimeve nga ndonjë kryes me të cilët është shkaktuar vdekja apo lëndimi i rëndë trupor⁴⁶. Nëse një i akuzuar ka treguar shtëpinë e të dëmtuarit dy të akuzuarve tjerë, ka dhënë detale përvendodhjen e të hollave etj, nuk kemi bashkëkryerje, por kemi shtyje në vepër penale të grabitjes.

Tentativa e këtyre veprave penale është e dënueshmë, gjegjësisht, te grabitja, tentative ekziston me vet faktin e fillimit të veprimeve të kryerjes, ndërsa te vjedhja grabitqare kjo nuk vihet në pyejte fare, sepse, aplikimi i forcës veç ka mundësuar mbajtjen e sendit. Nëse me përdorimin e forcës personi nuk është lënduar, atëherë kryesi përgjigjet përvepër penale të grabitjes apo vjedhjes grabitqare.

2.6 Dallimet dhe ngjashmëritë në mes të veprës penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes

Vjedhja grabitqare dhe grabitja janë vepra penale të përbëra dhe, mes veti të ngjashme sipas konstrukcionit. Edhe njëra edhe tjetra përfshijnë vjedhjen dhe dhunën (forcën) apo kanosjen, dhe, në shikim të parë, dallimi i tyre qëndron në mënyren e kryerjes së tyre. Të vjedhja grabitqare, kryesi së pari kryen vjedhjen e pastaj përdor dhunën më qëllim të mbajtjes së sendit të vjedhur, ndërsa të grabitja aplikimi i dhunës i paraprin kryerjes së vjedhjes.

Mirëpo, edhe pse këto vepra penale janë shumë të ngjashme, në rrafshin teorik dhe legjislativ të shteteve të ndryshme, nuk mund të flitet për një qëndrim unik.

⁴⁵ Po aty, fq.261;

⁴⁶ Srzentić Nikola, "Komentar krivičnog zakona Srbije, SAP Kosova i SAP Vojvodine", 1981, Beograd, fq.506;

Në parim, në sistemin kontinental dhe atë anglosakson, në kuptimin e konstrukcionit juridik të veprës penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes nuk ka dallime. Dallimet ekzistuese kanë të bëjnë me interpretimet e nocionit të *vjedhjes*, si dhe përcaktimit të *dhunës* ose *kanosjes* si “vepër e dytë penale” e cila përbënë strukturën e veprës penale të grabitjes.

Në kontekst të marrëdhënieve të ndërsjella teorike dhe praktike në mes të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes, duhet theksuar se nuk ka bashkim të veprave penale. Problematika e bashkimit të veprave penale në teori e veçanërisht në praktik bëhet e ndërlikuar, kur është fjala për vlerësimin se, në rastin konkret (me një apo më shumë veprime) a është kryer një apo më shumë vepra penale (...ko dilem paraqitet për shkak të përcaktimit ligjor të disa elementeve të njejtë për vepra të ndryshme penale...).

Kështu, nëse kryesi i grabitjes përdor forcën apo kërcënimin e kualifikuar të personave të cilët përpiken ti rimarrin sendet e vjedhura, atëherë do të ekziston vetëm grabitja si vepër e rëndë, e sipas parimit të konsumimit. Nuk është i mundur as bashkimi ideal në mes të lëndimit të lehtë trupor dhe grabitjes⁴⁷.

Gjithashtu, më shumë vepra penale të grabitjes nuk mund të kualifikohen si vepra penale në vazhdim, nese ato nuk janë kryer me shfrytëzimin e rastit të njejtë apo rrethanave të njejta, dhe nëse ato vepra penale nuk janë përfshirë me “dashje unike”⁴⁸.

⁴⁷ Jovašević Dragan, “Krivična dela razbojništva..., Bezbednost, Beograd, 2/2002, fq.256;

⁴⁸ Po aty, fq.257;

KAPITULLI – III

3. ASPEKTET KRIMINOLOGJIKE TË VEPRAVE PENALE TË GRABITJES DHE VJEDHJES GRABITQARE

Në çdo periudhë historike të zhvillimit të civilizimit dhe në çdo shoqëri ekzistojnë dukuri të cilat shkaktojnë pasoja të dëmshme. Këto dukuri janë të shumta, si përkah forma e manifestimit ashtu edhe nga përmbajtja. Mirëpo, dukurit e tillë gjenezën e tyre e kanë kryesisht në shoqëri dhe të individi.

Sipas botëkuptimeve të teorive strukturale, sjellja e individit si dhe “hyrja” e tij në botën e patologjisë sociale (krimit), determinohet nga pozita e tij në strukturën shoqërore dhe me prezencën e tij në një formë të caktuar në shoqërinë e dezorganizuar⁴⁹. Në këtë kuadër - të patologjisë sociale, participon edhe kriminaliteti i cili cenon vlerat më vitale të njeriut (...vlerat materiale, shpirtërore dhe jetën e njeriut, etj...). Duke i shkatërruar dhe rrënuar vlerat dhe të mirat e përgjithshme njerëzore, kriminaliteti fut në shoqëri psikozë të pasigurisë, shqetësimin dhe demoralizimin⁵⁰. Në këtë kontekst, veprat penale kundër psurisë në përgjithësi, për nga vëllimi dhe format e paraqitjes zënë vendin e parë. Këtë padashim e vërtetojnë të dhënat statistikore. Në aspektin kriminologjik, paraqitja, pjesëmarrja dhe format e manifestimit të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes dhe trajtat e cilësuara të këtyre veprave penale padashim janë për t'u brengosur.

Shqyrtimi, hulumtimi dhe trajtimi i veprave penale kundër pasurisë në përgjithësi dhe veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare në veçanti, nënkupton studimin e fenomenologjisë kriminale (...formën e paraqitjes...) dhe etiologjisë kriminale (...shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit...).

3.1 Fenomenologjia e veprave penale kundër pasurisë

Fenomenologjia kriminale është studiuar nga shumë autor, të cilët në kuadër të angazhimeve të tyre shkencore kanë përcaktuar nocinin e saj. Me këtë çështje vecanërisht janë marrë: Hans Gross, J. Pinatel, Ernest Selig, M. Singer etj. Sipas shumë autorëve, fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit, me strukturën dhe dinamiken e tij⁵¹. Termi “fenomenologjia” ka domethënien greke (*fainomen* – mësim mbi dukurin, dhe *llogos* – shkencë)⁵², respektivisht, paraqet pjesë të mësimit filozofik mbi dukurinë⁵³. Mbështetur në domethënien e saj, ajo trajtohet edhe në kontekst të kriminalitetit, e cila nënkupton studimin e trajtave të manifestimit, strukturën dhe dinamiken e kriminalitetit.

⁴⁹ B. Milosavljević, “Socialna patologija i društvo”, Beograd, 1977, fq.10;

⁵⁰ Millan Millotinović. Kriminologjia, përkthim në gjuhen shqipe, Prishtinë, nuk ka vit të botimit, fq.157;

⁵¹ Halili Ragip, “Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.112;

⁵² Milan Vučaklija, “Leksikon stranih reči i izraza”, Beograd, 1970, fq.1002;

⁵³ B. Milosavljević, “Socialna patologija i društvo”, Beograd, 1977, fq.43;

Kriminaliteti si dukuri shoqërore patologjike kategorizohet në grupin e manifestimit të rrezikshëm të njeriut ndaj njeriut dhe vlerave njerëzore. Natyrisht, kriminaliteti është fenomen që kërkon hulumtim thelbësor të: prezencës së saj në shoqëri; dinamikës së përhapjes; shtrirjes territoriale; strukturës së kriminalitetit; dhe personalitetit të delikuentit. Kërkimet empirike dhe të dhënat statistikore dëshmojnë se edhe veprat penale kundër pasurisë i nënshtrohen hulumtimeve të cekura më lartë në mënyrë që të diferencohen konkluzione përkatëse lidhur me fenomenologjin kriminale të këtyre veprave penale. Fenomenologja e këtyre veprave penale ofron të dhëna të cilat gjithnjë e më shumë këto vepra penale (...përvetësimi i sendeve të huaja të luajtshmë...) i kategorizon në grupin e kriminalitetit të dhunshëm, dhe në këtë rrafsh përmenden vjedhja grabitqare dhe grabitja, si dhe trajtat e cilësuara të tyre. Kryesit e këtyre veprave penale kanë veçorit e tyre specifike të cilat i përshkruhen moshave të caktuara, gjinisë së caktuar, përkatësisë së caktuar sociale, nivelit të caktuar arsimor, etj. Vështrimi themelorë i fenomenologjisë së kriminalitetit kërkon trajtimin e këtij fenomeni ndaj: gjinisë; moshës; strukturës së kriminalitetit; dhe dinamikës së kriminalitetit.

Shqyrtimi i fenomenologjisë së veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes në periudhën: 2006 – 2012 në territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës dhe Gjykatës e Qarkut në Pejë, tregon se pjesëmarrja gjinore është 100% në favor të meshkujve.

Ky raport i këtillë kërkon hulumtime sociologjike, psikologjike e të tjera për të marrë përgjigje në këtë çështje. Mirëpo, është qëndrim unanim se, dallimet në mes femrave dhe meshkujve në pjesëmarrjen në kriminalitet nuk e përcakton poli gjinor veç se socalizimi (shoqërorizimi) i tyre (...çasja e femrës ndaj normave të sjelljes është më e pranueshme se të meshkujt...).

- Mosha dhe kriminaliteti

Mosha është gjithashtu karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat statistikore nga praktika gjyqësore si dhe nga shënimet e kërkimeve empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme. Mirëpo edhe në këtë drejtim vërehen disa ligjshëmëri dhe kategori të moshave të cilat marrin më tepër pjesë në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale. Në literaturën kriminologjike dhe të dhënat nga praktika gjyqësore, del se grupet e tillë të moshave të kryerësve të veprave penale, pak a shumë janë të njëjta në të gjitha vendet e botës. Pjesëmarrja e moshave të caktuar dallon edhe në kyqjen e tyre në kryerjen e krimeve të ndryshme. Kësisoji mosha e re merr pjesë më shumë në kryerjen e krimeve kundër pasurisë si janë vjedhjet, vjedhjet me thyrje, plaçkitjet, trafiqet ilegale me narkotik etj. Ndërsa të rriturit në krimet tjera duke filluar prej krimeve kundër jetes dhe trupit, dhunimet, krimi i organizuar etj. Grupi i moshave 25-30 dhe 30-50, është grupi më aktiv, këto grupe të moshave, mësë shpeshti ballafaqohen me probleme të llojllojshme të jetës së përditshme, edhe ata vijnë në situatë që më së shpeshti kryejnë sjellje kriminale të cilat sjellin kriminalitetin në shoqëri.

- Gjinia dhe kriminaliteti

Gjinia në pjesëmarrjen e kriminalitetit, gjithashtu vështrohet në literatoren kriminologjike, në bazë të dhënave të statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore ekziston një përshtypje se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkulllore. Në shumë vende të botës, përkatësisht kryerësit e veprave kriminale të gjinisë mashkulllore, kanë dominuar në mënyrë absolute. Mirëpo tani, në shoqërinë bashkëkohore, gjendja ka ndryshuar dukshëm ngase edhe femrat, gjithnjë e më tepër, po marrin pjesë në kryerjen e sjelljeve të llojlojshme kriminale. Gjatë vitit 2003 sipas shënimive statistikore të gjykatave komunale të Kosovës mbi kryerësit e veprave penale sipas gjinisë dhe llojit të disa veprave del se 95% të këtyre veprave i kryejnë personat e gjinisë mashkulllore, e vetëm 5% të gjinisë femërore⁵⁴.

TABELA NUMËR 1: Veprat penale të grabitjes, vjedhjes grabitqare dhe rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo grabitjes, të zbërthyera në strukturë të moshava gjatë periudhës: 2006 - 2012⁵⁵.

I	II	III	IV	V	VI	
Nr. Rend.	Llojet e veprave penale	Rastet	Kryes	Mosha mesatare e kryesve	Të mitur	
					Kryes	Mosha
1	Vjedhje grabitqare Neni – 254	1	1	36		
2	Grabitja Neni - 255	15	26	25	2	18
3	Rastet e Rwnda Neni - 256	7	13	24	1	18

Të dhënat e paraqitura në tabel tregojnë se mosha mesatare e kryesve të këtyre veprave penale në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatën e Qarkut të Pejës në periudhën shqyruese është: për veprat penale të vjedhjes grabitqare – 36 vjet; për veprat penale të grabitjes – 25; dhe për rastet e rënda të këtyre veprave penale është – 24 vjet. Mesatarja e përgjithshme për këtë grup të veprave penale është – 28 vjet. Në këtë mesatare të moshës bëjnë pjesë edhe kryes të mitur. Mesatarja e konfirmuar më lartë në bazë të hulumtimit të bërë është e përafërt me grupin e

⁵⁴ Ragip Halili, "Kriminologjia", Prishtinë, 2005, fq.129-131

⁵⁵

Evidenca e Gjykatës Themelore të Gjakovës dhe Gjykatës së Qarkut të Pejës për veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastet e rënda te këtyre veprave penale, për periudhën: 2006 – 2012;

parë të teoricientëve të cilët konsiderojnë se mesatarja e moshës së këtyre kryesve sillet mes moshës 20 – 25 vjeç. Vlerësimi analistik i rasteve individuale le të kuptohet se nuk ekziston kriter i prerë (strikt) i moshës që i karakterizon kryesit e këtyre veprave penale. Mirëpo, është evident fakti se kryes të drejtpërdrejt të këtyre veprave penale janë persona relativisht të rinjë, ndërsa kur është fjala për organizator të grupit apo bandës ata janë të moshës mesatare (më të pjekur) sepse, ata kryejnë punët organizative dhe planifikimin e kryerjes së këtyre veprave penale.

Kriminaliteti dhe dinamika (vëllimi) – ky aspekt i fenomenologjisë përkitazi me veprat penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare do të trajtohen në këtë kapitull.

Struktura e kriminalitetit ndaj veprës penale – në shumicën e vendeve dominojnë veprat penale të përvetësimit të pasurisë së huaj, gjegjësisht, veprat penale kundër pasurisë. Raporti i veprave penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastet e rënda të tyre karshi veprave tjera të kriminalitetit pasuror është më i vogël, mirëpo, rrezikshmëria, pasojat materiale dhe njerëzore si dhe shkaktimi i frikës në masë (të veprave që janë temë e punimit tonë) e bëjnë këtë raport irrelevant.

3.1.1 Fenomenologjia e kriminalitetit pasuror – disa veçori të kriminalitetit kundër pasurisë

Kriminaliteti kundër pasurisë, për nga vëllimi dhe format e paraqitjes, pothuajse në të gjitha shtetet, zë vendin e parë. Këtë e vërtetojnë të dhënat statistikore për numrin e personave të akuzuar, respektivisht të dënuar.

Sipas Singerit, në kriminalitetin e përgjithshëm, pjesëmarrja e krimeve kundër pasurisë sillet rreth 60%⁵⁶.

Përveç vëllimit, këto vepra penale i karakterizon edhe:

- recidivizmi i shprehur i kryesve të veprave penale;
- profesionalizmi i kryesve të veprave penale;
- specializimi i kryesve të veprave penale;
- organizimi i kryesve të veprave penale në grupe dhe rrjete të organizuara regionale dhe ndërkombëtare (...grupet për kryerjen e vjedhjeve të automobilave, grabitjeve, shitjen e sendeve të vjedhura, etj...); dhe
- prania e numrit të errët i kryesve të veprave penale.

3.1.2 Fenomenologjia e recidivizmit të veprave penale kundër pasurisë

Në aspektin e patologjisë sociale, recidivizmi paraqet çdo kthim të sérishëm të individit në botën e patologjisë sociale.

⁵⁶ Halili Ragip, "Kriminologjia" Prishtinë, 2000, fq.188;

Nocioni i recidvizmit në kuader të kriminalitetit definohet nga aspekti:

- ***juridiko penal*** – ky përcaktim bazohet në kriteret formal-juridike;
- ***penologjik*** – nënkupton përcaktimin e saj pas çdo ardhje të sërishme në institucionin për ekzekutimin e dënimeve; dhe
- ***kriminologjik*** – nënkupton përcaktimin e recidives së një personi në kryerjen e veprës penale brenda pesë viteve⁵⁷.

Është pothuajse vlerësim unanim se recidivimi i kriminalitetit paraqitet më shumë si rezultat i mossuksesit të shoqërisë në përgjedhjen e instrumenteve për parandalimin e krimit se sa i vetë kriminelit ndaj të cilët është drejtuar politika ndëshkimore. Konsiderohet se, kryerja e sërishme e veprës penale paraqet indikator të prirjeve të zhvilluara kriminale për kryerjen e serishme të veprimtarive kriminale. Nga aspekti i burimit të recidvizmit konsiderohet se, nuk mund të flitet për një etiologji të veçantë e cila i shmanget suazave të etiologjisë së përgjithshme të kriminalitetit, kështu që, rrathi shoqërorë dhe personaliteti të cilët veprojnë në kryerjen e veprave penale janë relevante edhe kur është fjala për recidivist. Megjithatë, nuk mund të mohohet fakti se recidivimi paraqitet në disa rrethana specifike (...familjare; skamja; regjionet e zhvilluara, tretmanet joadekuate në institucionet për korrektim; shoqërimi me kriminel; mungesa e aftësimit profesional; dhe riintegrimi i vështirë i të dënuarve pas kryerjes së dënit...).

Rreziku nga recidivizi është më i madh në fazën e parë pas veprës së kryer penale. Nëse ka kaluar një kohë më e gjatë, e nuk ka kryer përseri veprën penale mund të konsiderohet se është kryer me sukses procesi i risocializimit. Në të kundërten, rrjedhë se ky proces ka dështuar.

Nëse prirjet kriminale janë më të shprehura, atëherë kemi edhe me probleme që ndërlidhen me personalitetin e kryesit të veprës penale. Këto prirje shtohen me çdo vepër të re penale dhe flasin për vështirësit e përmirësimit dhe adaptimit të tij. Natyrisht, pasojat në personalitetin e delikuentit janë më të mëdha, po që se një vepër penale është bërë në rinninë e hershme.

Nëse mirren parasysh këto cilësi personale, rrjedhë se recidivistët janë kategori esenciale e rrezikshme e delikuenteve. Kjo është arsyaja pse recidivimi është trajta më e rëndë e patologjisë sociale. Mirëpo, përkundër cilësive të përgjithshme sipas të cilave përbëjnë një kategori të veçantë të kryesve të veprave penale, recidivistët nuk përbëjnë grup homogjen (recidivistët janë persona me karakteristika të ndryshme psikologjike e të tjera)⁵⁸.

⁵⁷ B. Milosavljević, "Socialna patologija i društvo", Beograd, 1977, fq.88-89;

Me gjerësisht në librin universitar të Mllotinovič, M, "Kriminologjia", përkthim në gjuhën shqipe, Prishtinë, nuk ka vit të botimit, fq.210-218.

⁵⁸ B. Milosavljević, "Socialna patologija i društvo", Beograd, 1977, fq.88-89

Rëndësia dhe shkalla e rrezikshmërisë që paraqesin recidivistët në legjislacionet bashkëkohore penale ka ndikuar në definimin dhe kategorizimin e delikuentëve sipas tëndencave, e cila bazohet në konцепционет antropologjik-kriminologjik të kriminalitetit⁵⁹.

Duke patur parasysh rëndësin e recidivimit karshi politikës ndëshkimore, në teorinë juridike janë bërë përpjekje të klasifikimit të recidivistëve (...janë krijuar tipologji të ndryshme të tyre...). Kështu, Hurwitz i thekson vëgmas 2 tipe të recidivistëve (delikuentët nga shprehitë të cilët mund të janë aktiv dhe pasiv; dhe kriminelët e rrezikshëm). J. Pinatel, të gjithë recidivistet i ndau në 3 grupe: profesional, të paadaptuar dhe delikuent të rastit. Vëllimi i recidivimit ndryshon në vendet e ndryshme dhe është e nderlidhur me një varg rrethanash, siç janë: politika ndëshkimore, praktika e gjykatave, funksioni i enteve për risocializim etj. Pavarësisht nga faktet e cekura më lartë mund të thuhet se në recidivëm bie pjesa më e madhe e kriminalitetit.

Të dhënët statistikore për kryesit e veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë ofrojnë të dhëna ekzakte përfaktive se recidiva është prezente edhe në këtë lloj të kriminalitetit, nëse jo direkt, atëher indirekt, nëpërmjet recidivës së përgjithshme në deliktet kundër pasurisë. Shqyrtimi i fenomenologjisë së recidivimit të veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes në periudhën: 2006 – 2012, tregon se në territorin e këtyre Gjykatave janë kryer gjithsejtë: vjedhje grabitqare -1, grabitje -15, dhe raste të rënda -7. Këto vepra penale janë kryer nga – 43 kryes, dhe nga ky numër, 9 kryes edhe ma parë kanë kryer vepra penale të natyrës së njejtë.

3.1.3 Ecuria dhe dinamika e veprave penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, në periudhën 2008 – 2012.

Trajtimi i shtrirjes të këtij lloji të kriminalitetit, padyshim është me rëndësi vendimtare përvlerësimin real të saj, i cili është parakusht themlore përcaktimin e strategjisë nationale në luftimin e kriminalitetit.

Kosova në kuptimin gjeografik është vend i vogël, dhe duke patur parasysh këtë fakt, prezenca e këtij lloji të kriminalitetit në pjesë të ndryshme të saj është pothuaj e barabartë, respektivisht, edhe regioni i Gjakovës nuk është përjashtim.

Territori i Gjykatës Themelore të Gjakovës që nga 01 janari 2013 përfshinë: Gjakovën, Rahovecin, Malisheven dhe kjo Gjykatë Themelore ka kompetencen e saj dhe trajton të gjitha veprat penale në shkallë të parë sikurse edhe gjykatat tjera themelore në Kosovë. Pavarësisht, nga ndryshimet që kanë ndodhur, bazuar se në faktin se në periudhën shqyrtuese edhe veprat penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes të kryera në territorin e komunës së Gjakovës janë trajtuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Fenomenologjia e kriminalitetit në përgjithësi, ndërsa e veprave penale të vjedhjes

⁵⁹ Dr. L. Lazarević, "Provatnici, delikuenti po navici, profesionalni i delikuenti po tendenciji u savremenom krivičnom pravu" JRKKP, 1966/1, Beograd, fq.37;

grabitqare dhe grabitjes në veçanti, kërkon trajtimin e këtij fënomeni në raport me: vëllimin, ecurinë e këtyre veprave penale sipas viteve, përfaqësimin gjinor; moshën; strukturën e kriminalitetit; dinamikën e kriminalitetit, etj.

Evidencat e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykates së Qarkut të Pejës, për periudhën shqyruese pasqyrojnë prezencën e këtyre veprave penale në territorin e saj e cila nuk dallon dukshëm nga pjesët tjera të Kosovës. Është fakt i pakontestueshëm se vepra penale e vjedhjes grabitqare paraqitet vetëm (1) një herë, dhe këtë kryesish përfaktin se, kryesit e këtyre veprave penale nuk “nisen” në kryerjen e vjedhjes grabitqare, por përf të kryer vjedhjen, ndërsa aktet e dhunës paraqiten si “domosdoshmëri” përf të mbajtur sendin e vjedhur. Përf dallim nga kjo, vepra penale e grabitjes paraqitet në (15) pesëmbëdhjetë raste, ndërsa rastet e rënda të këtyre veprave penale, (...grabitjes...) shënon (7) shtatë raste. Kjo pasqyrë e rasteve të këtyre veprave penale, shikuar në kuptimin statistikor nuk paraqet shifër alarmante, mirëpo, duke qenë se kemi të bëjmë me vepra penale të rrezikshmërisë së lartë, konsiderojmë se prezenca e këtyre veprave penale kërkon trajtim serioz nga shoqëria jona⁶⁰.

TABELA NUMËR 2: Dinamika e veprave penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rasteve të rënda në periudhën: 2006 – 2012, sipas viteve⁶¹.

I	II	III	IV	V	VI
Nr.rendo		Neni-254	Neni-255 grabitje	Neni-256rastet rënda	Gjithësej
1.	2006			5	6
2.	2007		1	1	2
3.	2008		6		6
4.	2009		5	1	6
5.	2010	1	3		4
6.	Gjithësej	1	15	7	23

Evidencia e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykates së Qarkut në Pejë, për periudhën shqyruese pasqyron dinamikën e këtyre veprave penale në territorin e tyre, sipas të cilës viti 2012 shënon një zvogëlim të kryerjes së këtyre veprave penale, respektivisht, derisa në vitin 2008 kemi

⁶⁰ Evidencia e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykates së Qarkut në Pejë përf veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastet e rënda të këtyre veprave penale, përf periudhën 2006 – 2012;

⁶¹ Evidencia e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykates së Qarkut në Pejë përf veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rasteve të rënda të këtyre veprave penale, përf periudhën: 2006 – 2012;

5 raste, në vitin 2009 2 raste, 2010 – 2011 – kemi 6 raste, ne vitin 2012 këmi gjithsejtë 4 raste të këtyre veprave penale.

3.2 Etiologjia e veprave penale kundër pasurisë

Nocioni – Në shkencën e kriminologjisë etiologjia zënë pothuajse vendin kyq në hulumtimin e dukurive patologjike të shoqërisë, siç është kriminaliteti. Kjo çështje ndryshe njihet edhe si “faktorët kriminogen”, dhe në këtë kuadër trajtohet si problem themelore.

Etiologjia kriminale nënkupton studimin dhe njohjen e shkaqeve dhe kushteve të paraqitjes së kriminalitetit⁶². Në këtë kontekst, etiologjia kriminale përkon me ndriqimin e lidhjeve në mes dukurive të ndryshme të superstrukturës shoqërore – faktorët ojektiv. Natyrisht, kjo kërkon qasje interdisiplinare, e cila mundëson shpjegimin e shkaqeve të cilat shpien deri të kriminaliteti. Në mënyrë indirekte, roli primar i etiologjisë kriminale kushtëzon vendin dhe rolin e kriminologjisë si shkencë në luftimin e kriminalitetit.

Etiologjia kriminale – pikëpamjet teorike: Të gjithë teoricientet të cilët merren me studimin e etiologjisë kriminale pajtohen me qëndrimin se faktor kriminogen paraqesin të gjitha rrethanat, shkaqet dhe kushtët të cilat ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit. Mirëpo, përkitazi me faktin se cilët nga këta faktorë janë me ndikim vendimtar në paraqitjen e kriminalitetit, mendimet në teori janë të ndara.

në këtë kontekst, janë të njohura këto teori:

- **teoria e monofaktorit (...faktorit individual...)**- e përfaqësuar nga Q. Lombrozo, me teorin e kriminelit të lindur;
- **shkolla antropologjike** – vetit anatomike të njeriut determinojnë sjelljet kriminale; dhe
- **teoria e multifaktorëve** – në paraqitjen e kriminalitetit ndikojnë shumë faktorë: antropologjik, fizikë, social, faktor të jashtëm dhe të mbrendshëm, përfaqësuar nga G. Tardi, Enrico Feri dhe faktor subjektiv dhe objektiv përfaqësuar nga J. Pinatel, etj⁶³.

Përkundër dallimeve të theksuara të teorive të cekura më lartë, vërehet se, të gjithë faktorët mund të janë të natyrës subjektive dhe objektive, dhe sot, varësisht nga priorititet shkencore këto teori paraqiten si:

- **teoria e faktorit** - (lexo: monofaktori dhe multifaktori);
- **teoria funksionaliste** – institucionet shoqërore, si: politike, religjioze, ekonomike, kulturore-arsimore, etj, janë të ndërlidhura në mënyrë funksionale – Jeffery;
- **teoria e kauzalitetit** – janë faktorë shkakor të cilët diferencohen si: shkaqet (materiale, ideore, arsimore, etj) dhe kushte (papunësia, varfëria, depresioni etj); dhe **shkasi** – është shkak dhe kusht i sjelljes kriminale. Shembull: sjellja, provokimi nga ana e viktimitës.

⁶² Halili Ragip, “Kriminologjija”, Prishtinë, 2000, fq.217;

⁶³ Po aty, fq.219;

3.2.1 Rrënjet (shkaqet) e veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare.

Nacioni i kriminalitetit ngërthen në brendinë e saj tërësi të komplikuar shoqërore dhe, në fazat e ndryshme shoqërore-ekonomike ka pësuar një erupzion evolutiv, për të arritur në ditët e sotme fazën e saj kulminante e cila falë zhvillimit teknologjik manifestohet në format e saj të rrezikshmërisë së lartë, luftimi i të cilave kërkon aftësi profesionale, teknikë adekuate dhe bashkërenditje të veprimeve në plan të brendshëm dhe ndërkombëtar. Si dukuri e tillë, kriminaliteti i ka rrënjet, shkaqet, historin dhe manifestimet e veta. Trajtimi i këtyre komponentëve të kriminalitetit kërkon hulumtim të gjithanshëm, respektivisht, aspektet e ndryshme dhe ndikimet e ndërlikuara të rrethanave e faktorëve të ndryshëm.

Hulumtimet shkencore nxjerrin në pah shkaqe të ndryshme të cilat reprodukojnë kriminalitetin dhe ato mund të ndahanë në:

1. të përgjithshme:

- kundërthënya në mes nevojave dhe mundësive;
- tendenca e fitimit të profitit dhe e pasurimit;
- lidhshmëria e interesave personale dhe psikologjike individuale me sjelljen kriminale. Shembull: vjedhja dhe veprat penale kundër pasurisë shpesh shfaqen si shprehje e tendencave të tilla, prirjeve e psikologjisë individualiste. Kjo lidhje shprehet edhe atëherë kur si objekt i aktivitetit kriminal janë të mirat që s'kanë brendi materiale (...nderi, prestigji, etj...);
- tjetërsimi i personalitetit dhe sjellja kriminale;
- konflikti i kulturave dhe format e ndryshme të alienacionit të njerëzve;
- pabarazia, eksploatimi;
- lëvizjet migrative; si dhe
- shkaqet tjera të karakterit të përgjithshëm.

2. të vecanta – do t'i quaja specifike për krimet të caktuara. Në rastin tonë duhet specifikuar shkaqet e vecanta të cilat gjenërojnë krim, e sidomos ato që mund t'i përshkruhen veprave penale kundër pasurisë, e posaqërisht atyre, të veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, e sidomos trajtave të tyre të cilësuara (Lexo: këto specifika do të trajtohen më detalisht në pikat në vijim).

3.2.2 Faktorët kriminogjen të veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare

Të shumtë janë elementet, faktorët dhe situatat të cilat ndikojnë në paraqitjen e aktivitetit kriminal. Të gjitha këto, në literaturën përkatëse quhen “faktorë kriminogjen”. Duke qenë se këtu fjala është për kryesin e veprave penale, atëherë, kur bëhet fjalë për formimin e personalitetit i cili

devijon në krim, patjetër duhet analizuar rrethanat që kanë ndikim negative në individin. Etiologja kriminale duhet të jetë patjetër e orientuar në studimin e këtyre ndikimeve direkt kriminogjene⁶⁴.

Faktorët kriminogenë në aspektin e përgjithshëm përfshijnë të gjitha kategorit e kryesve të veprave penale, pra edhe ato që mund ti atribuohen kryesve të veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare. Natyrisht, secila vepër penale ka specifikat e veta, dhe në këtë kuadër edhe rrethanat me ndikim të kryesit e veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare kanë vëçantitë e tyre.

Për të eleminuar rrethanat të cilat nuk janë specifike për veprat penale kundër pasurisë, fillimisht do të trajtojmë faktorët e përgjithshëm kriminogen.

Faktorët e “përgjithshëm” kriminogen janë të shumtë, dhe si të tillë në teori kemi ndarje të ndryshme.

Enriko Feri, këta faktor i ndanë në 3 grupe:

- *antropologjik* (vetitë fizike të delikuentit);
- *fizikë* (vetitë anatomike të delikuentit); dhe
- *shoqëror* (ambient shoqëror ku jeton kriminel).

G. Tarde, faktorët kriminogenë i ndanë në:

- egzogenë; dhe
- endogenë.

Kjo ndarje në kriminologji është përvetësuar përgjithësisht.

Faktorët e jashtëm (egzogenë – objektiv) të kriminalitetit

Sipas shumë teoricenëve në paraqitjen e kriminalitetit, ndikimin më të madh e kanë faktorët e jashtëm. Faktorët e jashtëm janë të shumtë, mirëpo, në paraqitjen e sjelljeve kriminale, trajtohen:

- faktorët shoqëroro-ekonomik; ideopolitik; mikrogrupor; të patologjisë sociale; dhe ndikimet tjera⁶⁵.

Faktorët ekonomiko – shoqëror

Ndikimi i faktorëve ekonomiko – shoqërorë në paraqitjen e kriminalitetit padyshim është evident, dhe kur flitet për këtë ndikim fjala është për zhvillimin – industrializimin e hovshëm. Në këtë kontekst shtrohet pyetja – çfarë ndikimi ka zhvillimi i hovshëm industrial në procesin e formimit të personalitetit të njeriut? Zhvillimi industrial, padyshim ndikon në ngritjen e standartit të njeriut, por në anën tjetër një kategori e njerëzve vuajnë nga skamja; papunësia; shumë sëmurje të ndryshme (shembul: sida etj); shpërngulja e njerëzve nga zonat e pazhvilluara në qendrat urbane;

⁶⁴ Millotinoviq Millan, “Kriminologjia” Prishtinë, përkthim në gjuhën shqipe, nuk ka vit të botimit, fq.281;

⁶⁵ Po aty, fq.309;

migrimi në vendet tjera; depresionet ekonomike, etj. Në këtë kuadër përmenden edhe disa faktorë si: kushtet e vështira të banimit dhe profesioni. Mirëpo, hulumtimet e bëra vërtetojnë se këta faktorë nuk bënë të trajtohen si faktorë absolut në aspektin e ndikimit. Shumë raste të trajtuarë në gjykatë vërtetojnë se këta faktorë mund të kenë ndikim por jo edhe me çdo kusht.

Trajtimi i veprave penale kundër pasurisë, e veçanërisht veprat penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes vërteton se këta faktorë janë të rëndësishëm, sepse, statistikat tregojnë se, shumica e kryesve të veprave penale është kategori e personave të cilët kanë përfunduar në kriminalitet duke mos arritur ta përballojnë ndryshimet ekonomiko – shoqërore.

TABELA NUMËR 3: Statusi ekonomiko – social dhe arsimor si faktorë kriminogjen në paraqitjen e veprave penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastëve të rënda të këtyre veprave penale në periudhën: 2006 -2012⁶⁶.

I	II	III	IV	V		VI				VII	
Nr. Ren.	Llojet v.peale	K.mad hor	K.te mitur	Gjendja ekonomike		Arsimimi				Punë sim	
				varfr	Mesm	Anal	Fill	Mes	Stud	po	Jo
1.	V.grabit neni254	1			1			1			1
2.	Grabitje neni255	26	2	24	2	3	12	7	4	3	23
3.	R.rënda neni256	13	1	9	4	1	4	7	1	7	6
4.	Gjithësej	40	3	33	7	4	16	15	5	10	30

Evidenca e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë, për periudhën shqyruese pasqyron të dhëna të shumta për kryesit e këtyre veprave penale në territorin e tyre, sipas të cilës nga numri i përgjithshëm i kryesve – 40, të gjendjes së varfér ekonomike janë – 33, derisa niveli arsimor i tyre tregon se 4 katër – student. Nga kjo pasqyrë rrjedhë se numri më i madh i kryesve të këtyre veprave penale me arsimim të ulët. Është me interes të thuhet edhe fakti se nga numri i përgjithshëm i kryesve të këtyre veprave penale – 40, të punësuar janë – 10, ndërsa nuk janë të punësuar – 30.

⁶⁶ Evidenca e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë, për veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rasteve të rënda të këtyre veprave penale, për periudhën: 2006 – 2012;

Këto të dhëna vërtetojnë se faktorët ekonomiko – shoqërorë janë dëterminues relevant të kriminalitetit.

Faktorët ideo-politik

Këta faktorë përfshijnë një numër të madh të shkaqeve, kushteve dhe rrethanave shoqërore, të cilat ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit. Këto rrethana kanë të bëjnë me konfliktet e ndryshme ideore dhe politike. Në këte kuadër përmenden: konfliktet politike; konfliktet kulturore; luftërat; religioni; shtypi, etj⁶⁷.

Konfliktet ideo-politike janë prezent sidomos në vendet ish-komuniste, përbysja e të cilave sisteme ka ngjallur levizjet për të drejtat nacionale (...hegemonizmi etnik i një kombi ndaj një grupacioni tjetër etnik...). Kjo gjendje nxit konflikte politike, paraqiten kundërthënie të shumta, të cilat sjellin krime të llojullojshme⁶⁸.

Shembull tipik i nxitjes së konflikteve politike është procesi i shkatërrimit të RFSJ-së (...procese të shumta të montuara politike dhe luftërat në Bosnje, Kroaci dhe Kosovë etj...). Këto procese kanë nxitur një varg sjelljesh kriminale. Zakonisht, këto konflikte janë prezente në shoqërit multietnike, multipolitike dhe multikonfesionale. Në këto shoqëri ekziston supstrat i përshtatshëm edhe për paraqitjen e konflikteve kulturore (...grupet – individët përpinqen që botëkuptimet e veta të i'a imponon grupit tjetër...), të cilat shkaktojnë mostolerancë dhe urrejtje.

Konfliktet kulturore vërehen edhe gjatë procesit të migrimeve në relacionet fshat-qytet. Këto konflikte shoqërore janë rezultat i migrimeve nga shtetet e pazhvilluara në ato të zhvilluara. Natyrisht, ky botëkuptim është i mangët sepse, apstrahohen të gjithë faktorët relevant të cilët kanë ndikuar në paraqitjen e kriminalitetit nga radhët e “ardhacakëve”. Në kuadër të faktorëve ideo-politik, edhe luftërat paraqiten si relevant për dukurin e kriminalitetit, dhe ate, si gjatë përgaditjes së luftës, zhvillimit të saj edhe fazën e pasluftes. Në këtë kontekst janë të shpeshta veprat penale të vrasjeve, vjedhjeve, plaçkitjeve, dhunimeve seksuale etj. Kjo dukuri ka qenë prezent në luftërat e zhvilluara në vendet e ish-jugosllavisë, si dhe pas përfundimit të tyre. Në Kosovë ka qenë prezent gati çdo llojë i mundshëm i krimít, si: ndaj popullsisë civile, ndaj vlerave kulturore historike të shqiptarëve, pasurive private të luajtshme dhe të paluajtshme, pasurive publike, dhunimet seksuale, shkatërrimi i objekteve fetare etj. Pas luftës, varfëria, papunësia dhe problemet e trashëguara nga lufta kanë sjell paraqitjen e krimeve të ndryshme. Në këtë kuadër si shumë prezent paraqiten veprat penale kundër pasurisë.

Në grupin e faktorëve ideo-politik bënë pjesë edhe arsimimi, mjetet e komunikimit publik edhe religioni. Padyshim që, këta faktorë kanë ndikim në formimin e personalitetit të njeriut. Personat e arsimuar, të informuar mirë dhe drejtë, si dhe me një edukatë të mirëfilltë fetare, e kanë të vështirë të kyqen në kriminalitet. Mirëpo, rezultatet e hulumtimeve shkencore të bëra ndaj kryesve të

⁶⁷ Halili Ragip, “Kriminologjija” Prishtinë, 2000, fq.234;

⁶⁸ Dimitrijević Vojin, “Terorizam”, Beograd, 1983, fq116-118;

veprave penale në Amerikë, tregojnë, se 75% e të dënuarve u përkasin besimeve fetare – familjeve ku kultivohet religjioni. Kjo shtron pyetjen, se çka në të vërtet nxit religjioni?⁶⁹. Analiza të tilla në vendin tonë nuk ka, kështu që çdo vlerësim i paraqitur nuk do të kishte mbështetje shkencore – empirike.

Faktorët mikrogruporë

Këta faktorë janë të veçantë, dhe kanë ndikim të madh në formimin e personalitetit. Në këtë kuadër përmenden: familja, shkolla, lagja, mjedisi shoqërorë, etj.

Në pjesën më të madhe këto “bashkësi” kanë ndikim e veprim pozitiv dhe afirmativ në jetën e njeriut. Mirëpo, këto “institucione”, të një kategorë e individëve kanë lënë ndikime dhe gjurmë negative. Në këto relacione, hulumtimet shkencore nxjerrin në pah se, shkak i drejtpërdrejt i marrjes me veprimitari kriminale janë: sjelljet negative, traumat, konfliktet, përjetimet tragjike, etj. Hulumtimet e bëra tregojnë se të shumtën e rasteve delikuentët vijnë nga familjet e degraduara, deficiente apo edhe familjet shumëantarëshe (...familjet ku nuk ka mundësi të sigurohen kushtet ekonomike – materiale, etj), janë të nivelistë arsimimit jo të kënaqshëm, gjegjësisht, vijnë nga mjediset shoqërore (lagjet) ku shoqërohen me delikuent.

TABELA NUMËR 4: Mjedisi shoqërorë si faktorë kriminogjen në paraqitjen e veprave penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rasteve të rënda të këtyre veprave penale në periudhën: 2006 - 2012⁷⁰.

I	II	III	IV	MJEDISI SHOQËROR I KRYESIT	
				URBAN	RURAL
Nr.R	Ll.v.p	K.madhor	K. mitur		
1.	Neni 254	1		1	
2.	Neni 255	26	2	6	20
3.	Neni 256	13	1	6	7
4.	Gjithëse	40	3	13	27

Nga të dhënat e siguruara të evidencës gjyqësore lidhur me disa nga komponentet mikrogrupor – mjedisin shoqërorë, prej nga graviton kryesi i veprave penale, rrjedhë se shumica e tyre vijnë nga pjesët rurale (...këto regjione janë me zhvillim të ulët ekonomik, arsimor, kulturor, etj...). Kështu,

⁶⁹ Po aty, fq.251;

⁷⁰ Evidenca e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë, për veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rasteve të rënda të këtyre veprave penale, për periudhën: 2006 – 2012;

nga 40 – kryes të veprave penale në periudhën shqyrtyuese, 27 syresh vijnë nga pjesët rurale. Këto të dhëna statistikore kur të shpjegohen në lidhmëni me faktorët tjerë relevant për të cilët u fol më lartë, (...mosha, arsimimi, recidivizmi, gjendja ekonomike, papunësia, etj), formon një lepezë të “larmishmë” të faktorëve kriminogjen të cilët ndikojnë në përhapjen e kriminalitetit.

Faktorët sociopatologjik

Quhen sociopatologjik sepse janë rrjedhojë e gjendjes së sëmuar të shoqërisë (...degradimi i vlerave morale, njerëzore, sociale, etj...). Këta faktorë shpesh janë të kushtëzuar nga çrregullimet ekonomike, politike, kulturore, etj.

Si dukuri sociopatologjike në kriminologji përmenden: prostituciuni, alkoolizmi, narkomania, bixhozi, bredhja, lëmosha, aids-i, vetëvrasja, etj.

Në rrafshin e trajtimit të etiologjisë së veprave penale, dukuria e prostitucionit si faktorë sociopatologjik në historikun e saj është manifestuar si prostitucion ritual, religjoz, substitucional, kompensional dhe profesional⁷¹.

Duhet theksuar se edhe dukurit tjera sociopatologjike kanë ndikimin e tyre në paraqitjen e kriminalitetit. Mirëpo, jo të gjitha dukuritë janë relevante për vlerësimin e ndikimit të tyre në paraqitjen e kriminalitetit. Shembull: dukuria e bredhësve është relevante për paraqitjen e veprave penale kundër pasurisë.

Faktorët e brendshëm (endogenë – subjektiv) të kriminalitetit

Trajtimi i faktorëve të brendshëm të kriminalitetit nënkupton hulumtimin e personalitetit të njeriut – delikuentit. Rëndësin e këtyre faktorëve e vërteton edhe fakti se ndikimet e faktorëve të jashtëm (...për të cilat u elaburua më lartë...), varen shumë nga vetë struktura psikike dhe biologjike të personit. Ndryshtë, nëse ajo strukturë është normale, nëse nuk ka dëfekte, atëherë personaliteti i njeriut është më rezistent ndaj ngacmimive nga jashtë dhe anasjelltas. Në literaturë këta faktorë ndahen në psikologjik dhe biologjik⁷².

Faktorët psikologjik (psikikë)

Së bashku me bazën biologjike, personaliteti i njeriut është i ndërtuar edhe nga sfondi psikikë, e të cilat së bashku mundësojnë zhvillimin e personalitetit të njeriut. Bota shpirtërore e njeriut është komplekse dhe e nduarnduarshme⁷³.

⁷¹ Halili Ragip, “Kriminologjija” Prishtinë, 2000, fq.268;

⁷² Po aty, fq.309;

⁷³ Po aty, fq.310;

Ky kompleksitet i strukturës shpirtërore – psikike e njeriut kerkon hulumtim përkatës shkencor në mënyrë që të nxjerrin përfundime lidhur me determinuesit me ndikim në veprimet – sjelljet e caktuara të personit, qofshin ato pozitive apo negative (kriminale).

Hulumtimet shkencore kanë identifikuar këto veti – cilësi psikike të cilat formësojnë pësonalitetin e një individi, dhe këto janë: karakteri, temperamenti, emocionet, shprehitë, inteligjenca, aftësitë, qëndrimet, kujtesa të menduarit, motivet, etj⁷⁴.

Në procesin e hulumtimit të këtyre veticëve, është vështirë që në mënyrë ekzakte të përcaktohet shkalla e ndikimit të se cilës veti në sjelljen kriminale të individit. Është kështu sepse, këto cilësi shpeshherë janë të ndërlidhura, çka pamundëson trajtimin e izoluar të vetisë së caktuar. Këto cilësi të personalitetit, të cilat kushtëzojnë sjelljen e njeriut, shprehen gjithmonë në mënyrë individuale dhe konkrete⁷⁵.

Kjo veçanti individuale e cilësive nënkuption specificitetin e reagimit dhe sjelljen e individit të caktuar ndaj stimuluesve të jashtëm. Kjo nxjerrë në pah faktin se vetitë – cilësit personale paraqesin një komponent me rëndësi të gjitha formave të sjelljes kriminale (...çdo vepër penale e ka edhe anën e saj subjektive – motivin, aspiratat, etj...), mirëpo, edhe jo të pavarur. Çështja e veticëve personale dhe kriminaliteti paraqet një “tërësi” të komplikuar dhe njëherit të pandashëm në kuptimin e hulumtimit të këtij rapporti.

Karakteri – është veti kryesore e personalitetit të njeriut. Nacioni i karakterit në rrafshin kriminologjik është më i ngushtë se sa në kuptimin e saj të plotë. Kështu, si element të karakterit në kuptimin kriminologjik konsiderohen: vullneti, qëndrueshmëria, konsekuenca, iniciativa, guximi, siguria, etj. Njohja e këtyre veticëve ndihmon në ndriçimin e shkaqeve të sjelljes kriminale, e gjithashtu edhe në procesin e risocializimit dhe integrimit.

Temperamenti – nënkupton reagimin e individit ndaj ngacmimeve të jashtme⁷⁶. Klasifikimi i tipave të temperamentit sipas hipokratit është: kolerik, sanguinist, flegmatik dhe melankolik⁷⁷.

Shprehje, *Prirjet* – si veti psikologjike, krijohen, zhvillohen dhe ndryshojnë nën ndikimin e ambientit shoqërorë në të cilin jeton individi, Kështu, nëse në familjen ku jeton individi mbizotëron një ambient ku dukuri e rëndomtë është vjedhja, falsifikimi, etj, mund të pritet formimi i shprehive të tillë negative kriminale. Çështja e shprehive – prirjeve, veçanërisht janë më ndikim të recidivistët.

Inteligjencia – Intelegjenca përkufizohet si aftësi e të menduarit (...e zgjedhjes së problemeve dhe orientimit në situata të ndryshme...) Personat të cilët kanë aftësi që problemet t'i zgjidhin në mënyre të favorshme, më rrallë vijnë në situatë të merren me sjelljen delikuente. Shumë mendojnë

⁷⁴ Po aty, fq.310;

⁷⁵ Millotinoviq Millan, “Kriminologja” Prishtinë, përkthim në gjuhën shqipe, nuk ka vit të botimit, fq.374;

⁷⁶ Nushi Pajazit, “Psikologjia”, Prishtinë, 1996, fq.214;

⁷⁷ Po aty, fq.213

se personat me koeficient të ulët të intelejences marrin pjesë më shunë në kriminalitet, se sa ata me koeficient të lartë të intelejencës. Këto dallojnë kur mirret parasysh lloji i veprave penale. Kështu, personat me shkallë të lartë të intelejencës më shumë janë kryes të veprave penale kundër pasurisë, krimit të organizuar, drogës, etj. Njëherit, ata janë të shumtën organizator, planifikues – ideolog të kimeve⁷⁸.

E m o c i o n e t – Procesi i të menduarit dhe të gjykuarit shpeshherë – në rastet e caktuara kur ndërmerren veprime të caktuara, i nënshtronen edhe gjendjes së posaçme emocionale. Personat me sistem emocional jo stabil më lehtë i nënshtronen sjelljes kriminale. Në sferën e interesit tonë, duhet theksuar se gjendja afektive shpesh i paraprin kryerjes së veprave penale. Afekti është gjendje e veçantë emocionale intensive e cila paraqitet befas edhe aty për aty.

M o t i v e t – Sjelljet kriminale si aktivitete të vetëdijshme, me vullnet janë të nxitura nga motivet e caktuara. Këto nxitje i motivojnë interesat, nevojat, deshirat, etj. Edhe motivet, si cilësi-veti të personalitetit janë të ndryshme. Shembull: veprat penale kundër pasurisë i motivon interesin material. Shqyrtimi i rasteve të veprave penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe rastëve të rënda të këtyre veprave, pa asnjë dyshim vërteton se këto vepra janë të motivuara gjithherë nga interes material. Ky interes material dallon vetëm në natyrën (vlerën) e interesit material – para, stoli ari, prodhime nga teknologjia kompjuterike, telefona celular, etj.

Faktorët biologjik

Përveç faktorëve psikologjik, në personalitetin e njeriut mund të ndikojnë edhe faktorët biologjik. Mendimi i njohur i cili shkaqet e krimit i gjen në vetit anatomiko – biologjik të njeriut, është ai i Qezaro Lombrosos, sipas të cilit delikuenti nga jodelikuenti dallojnë nga pamja fizike (forma e kokës, simetria e gjymtyrëve të trupit dhe tipareve të tjera biologjike)⁷⁹.

Shmebull: shumë kriminel fizikisht janë shumë të fuqishëm dhe ata këtë fuqi “të tepërt” fizike e keqpërdorin në ndërmarrjen e veprimeve kundërligjore.

Mirëpo, realiteti ynë e relativizon këtë koncepcion sepse, kemi shumë raste kur personat me predispozita të jashtëzakonshme fizike bëhen sportist të dalluar. Me gjithë të dhënët statistikore nga hulumtimet e bëra të cilat relativizojnë teorinë e Lobrosos, është konstatim i pamohueshëm se zhvillimi normal harmonik biofizikë dhe biopsikikë është me rëndësi të madhe në pengimin e sjelljeve kriminale, ndërsa defektet psikofizike paraqesin bazë reale për paraqitjen e delikuenteve potencial.

⁷⁸ Millotinoviq Millan, “Kriminologjia” Prishtinë, përkthim në gjuhën shqipe, nuk ka vit të botimit, fq.389;

⁷⁹ Halili Ragip, “Kriminologjija” Prishtinë, 2000, fq.328;

Çrregullimet mentale dhe kriminaliteti

Në kuadër të ndikimit në sjelljen kriminale të faktorëve subjektiv, padyshim, se edhe çrregullimet mentale luajnë rolin e tyre dhe për këtë arsyе janë bërë studime të shumta. Në këtë drejtim vlen të përmendet mendimi të cilin e përfaqësojnë kryesisht autorët me orientim psikiatrik, se kriminaliteti është rezultat i çrregullimeve dhe patologjisë mentale⁸⁰.

Mirëpo, ky koncepti nuk është krejtësishtë i saktë, sepse, jo gjithmonë kryes të veprave penale janë personat me çrregullime mentale. Për këtë arsyë, tanë flitet për kriminalitet të cilin e kryejnë personat normal dhe kriminalitet të cilin e kryejnë personat me çrregullime mentale.

Si çrregullime mentale përmenden: neurozat, psikopatit dhe psikozat. Këto çrregullime manifestohen në forma të ndryshme.

Çrregullimet mentale të përmendura më lartë, nuk janë tipike për veprat penale kundër pasurisë, respektivisht për veprat penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare. Statistikat e nxjerrura për veprat penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes nuk ofrojnë të dhëna për pjesëmarrjen e personave me çrregullime mentale në kryerjen e këtyre veprave penale.

3.2.3 Tipologja e kriminelëve

Çështja e klasifikimit – tipologjisë së kriminelëve është me rëndësi të posaçme për kriminologjinë e në veçanti për penologjinë.

Rëndësia e tipologjisë së kriminelëve është e veçantë sidomos:

- nga aspekti i përgjegjësisë për veprën e kryer penale;
- nga aspekti i shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të cilën e tregon personi i caktuar;
- përkizazi me individualizimin e ekzekutimit të sanksioneve penale dhe riintegrimit të dënuarve; dhe
- lidhur me organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit të drejtë preventivë.

Mbështetur në relevancen e theksuar më lartë, si çështje që ka të bëjë me faktorin subjektiv, e sidomos me personalitetin e delikuentit, konsiderohet edhe tipologja e tyre (...të gjitha cilësitë e caktuara subjektive e karakterizojnë një delikuent si personalitet të veçantë...)⁸¹.

Sipas rëndësisë dhe qëllimit të klasifikimit të kriminelëve, autorët e ndryshëm bëjnë ndarje të ndryshme. Kështu, sipas disa autorëve flitet për klasifikimin: kriminologjik, penologjik, psikopatologjik dhe juridiko-penal.

⁸⁰ Po aty, fq.331;

⁸¹ Po aty, fq.349

Shembull: sipas kriterit juridiko-penal delikuentet kundër pasurisë i takojnë një grupi homogjen, ndërsa nga aspekti kriminologjik, sociologjik dhe penologjik, këta delikuent janë heterogjenë.

Me çështjen e klasifikimit të kriminelëve janë marrë shumë autorë të njojur dhe shkolla të caktuara. Për disa prej tyre shkurtazi do të paraqesim konцепционет e tyre.

Tipologja sipas Qesare Lobrozos – Lobrozo është përfaqësuesi më i njojur i shkollës antropologjike. Ai ka dhënë klasifikimin më të njojur të delikuentëve. Kriter themelor i klasifikimit të delikuentëve i Lombrozos është subjektiviteti i tij anatomiko-fizikë.

Delikuenti karakterizohet me strukturë të degjeneruar dhe plotë anomali anatomike dhe biologjike. Këto anomali Lombrozo i përshkruan në detale si duken (...pjesët e trupit...) për të cilat nuk do të detajojmë më gjatë.

Lombrozo në veprën e tij “Njeriu delikuent”, kriminelët i klasifikon në:

- kriminel të lindur;
- kriminel të sëmurë psikik;
- kriminel nga pasionet;
- kriminel nga shprehitë (...është tipike për kryesit e veprave penale kundër pasurisë...); dhe
- kriminel të rastit.

Tipologja sipas shkollës pozitiviste (Enriko Ferri) – Enriko Ferri, kriminelët i ndanë, në:

- kriminel nga shprehitë, dhe
- kriminel te rastit
- Përveç këtyre dy drejtimeve (të cilat kanë dallime dhe ngjashmëri), në literaturën kriminologjike hasim edhe në drejtime tjera të cilat bëjnë përpjekje për unifikimin dhe tejkalimin e dallimeve, siç janë:
- shkolla sociologjike – List, Prins, etj, kriminelët i ndajnë në akut dhe të pérhershëm;
- shkolla austriake dhe gjermane – Eksner, Selig, etj, kriminelët i ndajnë në karakterologjik, biottrashëgues dhe kriminal-politik.

Përveç sistemeve të theksuara klasifikuese të delikuentëve të cilat i kemi paraqitur, ekzistojnë edhe shumë tipologji të tjera. Natyrisht, ka edhe teori të cilat vetëm pjesërisht mund të aprovohen, pasi qëndrimet e tyre tipologjike janë të tepruara, prandaj nuk mund të flitet për sistemet klasifikuese definitive me tipizime të plota. Këto sisteme duhet të verifikohen në praktikë, të përpunohen dhe plotësohen në bazë të studimeve më të reja.

Kohëve të fundit, në qarqet e caktuara shkencore janë duke u bërë përpjekje për themelimin dhe hartimin e një klasifikimi shkencor⁸².

⁸² Po aty, fq.361;

3.2.4 Kryesit e veprave penale kundër pasurisë

Kryesit e këtyre veprave penale, në esencë paraqesin kategorin e kriminelëve, të cilët përveç karakteristikave të përbashkëta me kriminelët e veprave tjera, kanë edhe specifikat e tyre, të cilat përkojnë me:

1. Aftesit për kryerjen e krimeve;
2. Shprehitë për kryerjen e krimeve;
3. Paturpësia për kryerjen e krimeve;
4. Mënyra e kryerjes së krimeve;
5. Koha e kryerjes së krimeve
6. Objekti i sulmit;
7. Invencioni (fantazija) me të cilën udhëhiqet gjatë kryerjes së veprës penale;
8. Recidivizmi;
9. Edhe pas vuajtjes së dënimit rikthehen në “zanatin e vjetër”;
10. Përsosja e “zanatit” gjatë vuajtjes së dënimit;
11. Specializimi i kryesve për modus operandi; dhe
12. Përsosja permanente e tyre në kryerjen e veprave penale⁸³.

Profili i grabitqarit

Profilimi nënkupton procedurën e hartimit të versionit për kryesin e mundshëm në bazë të informatave të cilat dalin nga vetë përmbajtja e veprës penale, me qëllim të gjetjes së kryesit.

Specifikat e kryesve të veprave penale të cilat atribuohen veprave të caktuara penale, krijojnë modalitete, të cilat lindin në raport me:

- . Vendin e kryerjes (locus operandi);
- . Mënyra e kryerjes (modus operandi);
- . Kohën e kryerjes (tempus operandi);
- . Lëvizjen e kryerjes (radius operandi); dhe
- . Mjetet e kryerjes (instrumentarium operandi).

Modalitetet e krijuara në raport me elementet e kryerjes së veprave penale, paraqesin bazë relevante për specifikimin e kryesve të veprave penale. Hulumtimet e bëra të veprave penale kundër pasurisë, respektivisht, grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, nxjerrin në sipërfaqe specifika të caktuara të cilat janë të veçanta për këta kryes.

⁸³ Matijević Mile, “Oktrivanje imo vinskih krivični djela na usnovu tragova primjenom kriminalističkog modeliranja i geografskog profilisanja” fq.173-175.

Kështu, profili i një grabitqari duket si vijon:

- Kryes të veprave penale të grabitjes dhe vjedhjeve grabitqare janë meshkuj të moshës së re apo të mesme;
- Kryes të këtyre veprave penale, kryesisht janë të paarsimuar;
- Kryes të këtyre veprave penale janë të papunë;
- Kryes të këtyre veprave penale janë egalitar;
- Kryes të këtyre veprave penale gjithnjë e më shumë veprojnë edhe në grup;
- Kryes të këtyre veprave penale gjithnjë e më shumë përdorin armë zjarri;
- Kohët e fundit, vërehet rritja e numrit të femrave në kryerjën e këtyre veprave penale;
- Kryesit e këtyre veprave penale, përdorin dhunën në masë disproporcionale ndaj personit i cili i kundërvihet kryesit (...tregon edhe një karakteristikë psikologjike e cila nuk përkon vetëm me interesin material, por edhe me vetëkënaqjen e tij në shkaktimin e mundimeve tjetrit)⁸⁴;
- Kryesi i këtyre veprave penale e dëshiron konfrontimin fizikë me viktimin; dhe
- Grabitqari është fajtorë agresiv. Është vlerësim i përgjithshëm se angazhimi në masat preventive dhe repressive në çthurjen e grabitjes duhet filluar nga ky profil i grabitqarit

4. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I VEPRAVE PENALE TË GRABITJES DHE VJEDHJES GRABITQARE

Në qarqet shkencore, çështja e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit në përgjithësi njihet si politika kriminale. Historikisht, shoqëria njerëzore që nga format e saja primitive të organizimit është përpjekur t'i evitoj sjelljet me të cilat shkelen rregullat e shoqërive përkatëse dhe raportet në të cilat ato bazohen.

Si koncept, politikat kriminale përcaktohen në mënyra të ndryshme. Sipas konceptit klasik (List, Ancel, etj), politika kriminale është një model ideal i luftës kundër kriminalitetit. Përkufizimet tjera, politikën kriminale e trajtonë si politikë kriminale që zbatohet në praktikë, pavarësisht nga efektiviteti i saj⁸⁵.

Përndryshe, politika kriminale është krijuar si e arritur e konceptit liberal të shoqërisë civile të ndërtuar gjatë shekujve 17-18, dhe e formësuar në fillim të shekullit 19⁸⁶.

Në aspektin e përkufizimit të saj, politika kriminale është shkencë mbi vprimtarinë më cilësore të shoqërisë në luftimin e kriminalitetit. E kuptuar kështu, politika kriminale përfshinë politikën e luftimit të kriminalitetit në fushën e të drejtës penale (kuptimi i ngushtë i politikës kriminale); dhe në planin e gjërë të politikës sociale (kuptimi i gjërë i politikës kriminale). Natyrisht, në etapat e

⁸⁴ Modly, D, "Metodika istraživanja razbojništva" FKN, Sarajevo, 1999, fq.211;

⁸⁵ Latifi Vesel, "Politika Kriminale". Prishtinë, 2011, fq.57;

⁸⁶ Po aty, fq.9;

caktuara të zhvillimit historik janë aplikuar mjete dhe masa të ndryshme në luftimin e dukurive kriminale. Në planin e aplikimit të sanksioneve penale pas luftës së dytë botërore vërehet tendencë e respektimit dhe mbrojtjes së personalitetit të njeriut, humanizmi dhe demokratizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Spektri i sanksioneve penale pasurohet, përveç dënimeve, edhe me masat e sigurisë dhe ato edukative. Në kushtet bashkëkohore gjithnjë e më shumë insistohet në preventivën sociale të kriminalitetit.

Aspektet e ndryshme të cekura nxjerrin përfundimin se politika kriminale hulumton, bënë vlerësimë kritike dhe propozon masa për përmirësimin e tij në luftën kundër kriminalitetit. Nga kjo del se, fushëveprimi i politikës kriminale është më e gjërë se aplikimi i të drejtës pozitive, respektivisht, lëmia e tërësishme e politikës kriminale ndahet në tri fusha të veprimit:

1. Niveli i përgjithshem teorik dhe kushtet shoqërore;
2. Lufta penalo-juridike kundër kriminalitetit; dhe
3. Parandalimi shoqëror i kriminalitetit⁸⁷.

Gjërsia e fushëveprimit të politikës kriminale vënë në pah nevojën e përcaktimit të prioriteteve në aplikimin e masave për luftimin e kriminalitetit. Kjo çasje në veçanti vlenë për Kosovën. Kështu, periudha shumëvjeçare e sundimit serb në Kosovë, lufta, shkatërrimet materiale, njerëzore dhe shpirtërore, vendosja e institucioneve demokratike, problemet në funksionimin e organeve të pushtetit në shtetin e ri të Kosovës, kriza ekonomike dhe sociale, procesi i tranzpcionit, etj. Ky realitet plural i shoqërisë tonë, në mënyrë imperative ashpërsion konfliktet në mes njerëzve dhe pushtetit në të gjitha segmentet, shkakton diskriminime të llojeve të ndryshme.

Të gjitha këto rezultojnë me reagimin e individit ndaj këtyre parregullsive të cilat përfundojnë me kryerjen e veprave të ndryshme penale.

Në këto raste, natyrisht, forcohen tendencat represive, mirëpo, shtrohet pytja, a thua, ashpërsimi i masave represive është përgjigje në luftimin e kriminalitetit, dhe, sa ky proces vënë në pyetje legjitimitetin e aparatit represiv?

Konsiderohet se ashpërsimi i masave represive në luftimin e kriminalitetit nuk është përgjigje, respektivisht, aplikimi i sanksioneve penale duhet kuptuar vetem si një segment të rëndësishëm në kurpusin e masave që ndërmerren nga shoqëria e organizuar – shteti, në luftimin e kriminalitetit dhe risocializimin e kryesve të veprave penale. Sanksionim i veprave (...si institucion i të drejtës penale...) nënkupton kufizimin (ndalimin) e dhunës në marrëdhëniet ndër njerëzore.

⁸⁷ Po aty, fq.10;

4.1 Politika kriminale për parandalimin dhe luftimin e veprave penale kundër pasurisë

Luftimi dhe parandalimi i veprave penale kundër pasurisë shënon fillimin me paraqitjen e pronës private, gjegjësisht me sanksionin e veprave penale kundër paurisë i cili proces në etapat e caktuar historike i nënshtrohet zhvillimit të saj evolutiv. Në etapat e para të zhvillimit të legjislacionit penal – sistemi klasik i përgjegjësisë penale (...dënim...), shprehet si mënyrë e reagimit dhe mjet kryesore i politikës kriminale të shoqërisë klasore, duke konsideruar se frika si qëllimi i dënit të largon njeriun nga vepra penale⁸⁸.

Mund të thuhet se, deri të paraqitja e shoqërive bashkëkohore, veprat penale kundër pasurisë janë luftuar kryesisht me sanksione penale. Sot, duke patur parasysh kategoritë e reja të kryesve të këtyre veprave penale, shoqëria bashkëkohore nëpërmjet instrumenteve shtetërore dhe të tjera e ka zgjeruar korpusin e saj me aplikimin e masave edukuese dhe masat tjera parandaluese – të prevencionit.

Politika kriminale në procesin e parandalimit dhe luftimit të veprave penale në përgjithësi, dhe atyre kundër pasurisë në veçanti ka kaluar nëpër 2(dy) etapa:

. politika e hershme kriminale është përqendruar në masat ndaj individit (kryesit te veprës penale) dhe në këtë drejtim sistemet ndëshkimore janë përsosur në vazhdimësi; dhe

. politika bashkëkohore kriminale në vazhdimësi, është duke marrë karakter të një provencioni. Prevenca kriminale në kuptimin e saj përbajtësor ngërthen “aksionin shoqëror”, në luftimin e kriminalitetit. Këtë e kanë vërtetuar hulumtime të shumta shkencore. Në esencë, prevenca kriminale, paraqet konstrukcion të gjërë të elementeve të ndryshëm nga lëmia legjislative, sociale, familjare, arsimore, avansimi i kushteve profesionale, format e ndryshme të rekreacionit dhe integrimit në strukturat e organizimit shoqëror (...komuna...).

Politika kriminale përfshin dy fusha të parandalimit:

- . fushën juridiko-penale; dhe
- . të parandalimit të përgjithshëm social.

Në kontekstin e politikës kriminale bashkëkohore, parandalimi i përgjithshëm social është prioritar dhe ajo kërkon qasje multidisiplinare dhe në aspektin institucional gjithpërfshirëse me qëllim të arritjes se rezultateve pozitive.

⁸⁸ Po aty, fq.30;

Prevencioni i përgjithshëm social është aktivitet me karakter shoqërор, i orientuar drejtë luftimit të kriminalitetit si dukuri negative shoqërore⁸⁹.

Kategorizimi i masave të prevencionit të përgjithshëm social, në trajtimin teorik është i llojlojshëm. Mirëpo, si më gjithpërfshirëse është ndarja e këtyre masave, në gjashtë grupe të posaçme: ekonomike, sociale politike, juridiko-shtetërore, social-psikologjike, edukative, kulturore dhe sociale, të cilat, secila në segmentin e saj shpien drejtë forcimit të strukturave shoqërore në procesin e luftimit të kriminalitetit.

Luftimi i kriminalitetit, përvèç prevencionit të përgjithshëm social, njeh edhe formën e veçantë të njohur si parandalimi individual. Kjo formë e vaçantë është e ndërlidhur me individ të caktuar konkret, në mënyrën që ata të mos bëhen kriminel. Kjo ka të bëjë edhe me personat e dënuar edhe gjinden në vuajtjen e sanksionit penal – prevencioni ligjor (...aktiviteti i judikaturës penale...)⁹⁰.

Trajtimi i politikës kriminale në kuptimin e subjektit – institucionit (bartësit të prevencës) të prevencës kriminale ndryshe emërtohet si faktor i cili mund të jetë: preventiv ose represiv.

4.1.1 Faktorët preventiv (themelor, ndërkombëtar dhe shkencor)

Në çdo shtet demokratik, politika kriminale, si parim të saj themelor ka mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Shteti, si bartës i funksioneve të domosdoshme në organizimin e jetës në shoqërin e caktuar njerëzore, ka për dëtyrë të ndërtojë një politikë kriminale të mbështetur në parandalimin e përgjithshëm dhe konkret, në zbatimin e alternativave të dënimeve, në riedukimin dhe kthimin e të dënuarve ne shoqëri, në jetë, punë e në familje⁹¹.

Në këtë drejtim funksioni i shtetit, me qëllim të hulumtimit të tij dhe krijimit të kushteve për zhvillim pozitiv të njeriut, konsiston në modifikimin e rrethit shoqëror dhe në aplikimin e metodave të orientuara kah individët të cilët tregojnë shenja të mospërshtatjes, osë janë kryes të veprave penale (...me qëllim që te ata të nxisin ndërrime të caktuara psiko – sociale...), të cilat i bëjnë ata më rezistent kundër sjelljes sociale dhe delikuente. Në këtë drejtim, shteti paraqitet si formë e organizimit në kuadër të cilët funksionojnë faktorët themelor preventiv, të cilët në nivele të ndryshme merren me aktivitete të parandalimit të sjelljeve asocial dhe kundërligjore.

Bartësit kryesorë (themelor) të parandalimit të kriminalitetit janë:

- Familja – duke qenë se është faktor me rëndësi në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të njeriut, ajo paraqet instancë themelore në prevencionin e vepres penale.
- Shkolla – roli i saj në prevencion është i shumëfisht – edukativo, arsimor, kulturor, social, etj.

⁸⁹ Latifi Vesel, "Politika Kriminale". Prishtnë, 2011, fq.186;

⁹⁰ Po aty, fq.191-192;

⁹¹ Ismet Elezi, Vasilika Hysi, "Politika Kriminale", Tiranë, 2006, fq.126-127;

- Institucionet e specializuara – janë institucione në të cilat korreksioni dhe aktivitetet tjera përmirësuese orientohen në bazë të njohurive profesionale nga lëmia e psikologjisë, pedagogjisë, etj.
- Përgaditja, orientimi professional dhe punësimi – arsimimi dhe punësimi paraqet zgjidhje të rëndësishme në parandalimin e kryerjes së veprës penale.
- Ndihma postpenale – është e domosdoshme, sepse, të dënuarit gjatë qëndrimit në burg fitojnë edhe shprehi të tillë të cilat në liri ndikojnë negativisht në përshtatjen në jetën në liri. Po qëse nuk u afrohet ndihmë të dënuarve të tillë ata nuk do të mund të zgjidhnin shumë problem dhe vështërsi, dhe në këtë mënyrë mund të bijnë në sprova që ta zgjedhin sërisht sjelljen e rrezikshme shoqërore. Në këtë kontekst fjala është për dy lloj ndihmash: **e brendshme** (konsiston në dhënie të nxitjeve guximit dhe këshillave në institucionin përkatës) dhe **e jashtme** (qëndron në dhënien e ndihmave material, sigurimin e punës, banimit etj).
- Trajtimi individual dhe grupor – zbatohet ndaj delikuenteve të caktuar në institucione të caktuara ndaj anëtarëve të bandave dhe grupeve të të rinjëve. Kohët e fundit ky trajtim realizohet në fabrika, njësi të armatës etj. Kjo çështje është trajtuar në grupin konsultativ të OKB-së në Gjenevë në vitin 1961, si dhe në kolokuumin ndërkombëtar të fondacionit për dënlime dhe ekzekutimin e tyre në Bruksel, në vitin 1962. Në këto tubime janë marrë qëndrime në lidhje me vlerën e këtyre trajtimeve. Këto forma të trajtimit më shumë janë avancuar në shtetet e zhvilluara të perëndimit si në Kanadë, SHBA etj⁹².
- Roli i mjeteve të informimit – padyshim, në rrethanat e sotme bashkëkohore luan rolin e rëndësishëm në parandalimin e kriminalitetit.

- Roli parandalues i organizatave ndërkombëtare

Bazuar në faktin se kriminaliteti paraqet dukurinë e cila nuk është territorialisht e kufizuar, konsiderohet se një “aksion preventiv ndërkombëtar” mund të parandaloj në masë të madhe ekspansionin e kriminalitetit në botë. Këtu, në radhë të parë duhet përmendur Kombet e Bashkuara (në suaza të seksionit për mbrojtjen popullore), e në kuadër të saj:

- Seksioni për prevencionin e kriminalitetit dhe për judikaturë penale; organizata ndërkombëtare e punës; organizata ndërkombëtare e shëndetësisë; shoqata ndërkombëtare për të drejtën penale; organizata ndërkombëtare e policisë ndërkombëtare; komisioni për çështje sociale mbi parandalimin e kriminalitetit dhe trajtimin e delikuenteve;
- Shoqata ndërkombëtare për mbrojtjen e re shoqërore;
- Shoqata ndërkombëtare për kriminologji;
- Rregullat standard minimale të OKB-së mbi trajtimin e personave të burgosur;

⁹² Latifi Vesel, “Politika Kriminale”. Prishtinë, 2011, fq.215;

- Rregullat evropiane të burgut dhe shumë organizatave tjera të cilat në kuadër të angazhimeve të tyre merren me aktivitete parandaluese të kriminalitetit⁹³.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi ndërkombëtar policor, gjyqësor dhe i ekzekutimit të sanksioneve penale, paraqet padyshim hallkë të rëndësishme në luftimin, zbulimin dhe ndëshkimin e kryesve të veprave penale. Në këtë kuadër më së largu është shkuar me bashkpunimin policor (Interpol, Europoli dhe format tjera të bashkëpunimit). Bashkëpunimi ndërkombëtar i cili funksionon në kuadër të Interpolit konsiston në grumbullimin dhe këmbimin e informatave, zgjidhjen e çështjeve të ndërlidhura me hetime policore, ndihma juridiko-penale, këmbimi i informatave në lëmin e luftimit të kriminalitetit (...edhe në korpusin e veprave penale kundër pasurisë kur është fjala për aktivitetet e grupeve kriminale si dhe kapja e kryesve të këtyre veprave...) dhe asistenca në fushën e kriminalistikes⁹⁴.

- Faktori shkencor

Veprimi institucional shoqëror kundër kriminalitetit nënkupton njohjen e duhur të etimologjisë, fenomenologjisë dhe karakteristikave tjera të mjedisit ku trajtohet krimi. Kjo nënkupton ndihmën e mendimit kritik shkencor (...rezultatet e hulumtimeve konkrete empirike...). Është i nevojshëm zbulimi i stimulansave dhe ndikimeve negative në rrëthin shoqëror, të cilat i fusin individët në sjellje kriminale. Shkenca dhe të arriturat e saj, dukshëm kanë lehtësuar luftimin e kriminalitetit në përgjithësi, e veçanërisht në luftimin e kriminalitetit pasuror. Në këtë kontekst duhet përmendur sidomos zbulimin e mjeteve dhe metodave të shumta kriminalistike në ndriçimin e këtyre krimeve. Natyrisht, intencë e përhershme e shkencës është që gjithnjë të jetë një hap para kryesve të veprave penale, dhe në këtë drejtim bëhen investime të mëdha.

4.1.2 Faktorët represiv – institucional (Policia, Prokuroria, Gjykatat dhe Entet Korrektuese)

Politika kriminale e sistemeve përkatëse shoqërore nuk mund të ketë rezultate të suksesshme në luftimin e kriminalitetit, nëse subjektet e specializuara (...policia, prokuroria, gjykata dhe organet tjera...) nuk i kryejnë dëtyrat e veta preventive dhe represive në luftimin e kriminalitetit.

Në kuadër të procesit të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit në përgjithësi, ndërsa të veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare në veçanti, çdo shoqëri e organizuar – shteti, në kuadër të politikës kriminale, përveç masave preventive aplikon edhe masa represive të cilat i zbatojnë organët e pushtetit – Policia, Prokuroria, Gjykata, dhe Entet Korrektuese. Në rrafshin teorik, lidhur me këta faktor, ka ndarje të ndryshme. Veçmas përkrahet përcaktimi se institucionet e përfshira në politikën kriminale represive, ndryshten quhen institucionet ligjore⁹⁵.

⁹³ Halili Ragip, "Penologja", Prishtinë, 2009, fq.123-139

⁹⁴ Salihu Ismet, " E drejta penale ndërkombëtare", Prishtinë, 2011, fq.248-249;

⁹⁵ Millutinoviq Millan, "Kriminoljgia", Prishtinë, përkthim në gjuhën shqipe, nuk ka vit të botimit, fq.475;

Në këtë kuadër, organet të cilat veprojnë në këtë drejtim pothuajse në rend të parë – angazhim primar, e kanë luftimin e kriminalitetit. Ndryshe, represioni ka qenë edhe është karakteristikë qenësore e shoqërisë së organizuar – shtetit në procesin e luftimit të kriminalitetit.

Roli represiv i shtetit i cili me shekuj ishte dominant, deri në ditët tona, shpesh është kritikuar nga idetë humaniste dhe iluministe. Natyrisht, sot roli represiv i shtetit ka për qëllim riedukimin dhe riintegrin e delikuenteve si qëllim themelor të tij.

Përkundër përpjekjeve të mëdha të shoqërive demokratike në orientimin e politikave represive të shtetit (në luftimin e kriminalitetit) në drejtim të ndikimit të risocializimit, parandalimi i kriminalitetit nuk mund të merret me mend pa organe të afta të shtetit për zbulimin e veprave penale, kapjen e kryesve të tyre para organeve të drejtësisë.

- **Policia dhe parandalimi i kriminalitetit**

Në funksionin e çdo sistemi shoqëror politik ekzistojnë organet dhe shërbimet e specializuara që merren me luftimin e kriminalitetit. Këtë detyrë e ka policia duke u organizuar në forma dhe mënyra të ndryshme, me mjete dhe metoda vetanake, si dhe me autorizime të posaçme për t'i zbatuar detyrat e zbulimit dhe luftimit të kriminalitetit në përgjithësi.

Aktivitetet e policisë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit janë të përcaktuara me dispozita ligjore të Kushtëtutës, KPPK-së, Ligjit për Policinë dhe me dsipozita – rregulla tjera.

Në këtë kuadër, prioritare janë mbrojtja e jetës, pronës dhe ofrimi i sigurisë së përgjithshme të personave.

Në këtë kontekst duhe theksuar edhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, i cili me dispozita përkatëse parasheh të drejtat, detyrime dhe autorizime të caktuara (...në procëdurën parapenale, paraprake dhe në fazat tjera të procëdurës penale...).

Me qëllim të realizimit të detyrave nga kompetnca e saj, Policia, konformë dispozitave ligjore të Ligjit për Policinë, Kodit të Procëdurës Penale dhe dispozitave tjera ligjore ndërmerrë veprime të caktuara të cilat në raste të caktuara kufizojnë lirinë e levizjes, ndalojnë përkohësisht personin, sekuestrojnë përkohësisht sendet e caktuara, bëjnë kontrollin parandalues të personave, mjeteve motorike, përdorin forcën dhe armën e zjarrit etj. Duke patur parasysh faktin se aktiviteti i Policisë është shumë i përafërt me institucionet e judikaturës, ajo llogaritet në mesin e institacioneve të judikaturës penale.

Në veprimtarin parandaluese të kriminalitetit, Policia regjistron veprat penale; vlerëson peshën e tyre; vlerëson metodat e veprimit të delikuenteve; dhe analizon territorin dhe kohën e kryerjes së veprave penale. E tërë veprimtaria policore mundëson krijimin e pasqyrës mbi gjendjen e sigurisë së qytetarëve, që është posaçërisht e rëndësishme në aspektin politik dhe kriminal. Kohëve të fundit, veprimtaria policore shtrihet edhe jashtë qarqeve të zbatimit të së drejtës penale dhe repressive duke kryer edhe shërbime sociale.

Kërkimet bashkëkohore të aktivitetit policor tregojnë se aktiviteti i policisë po transformohet gjithnjë e më shumë në kuptimin preventiv. Prevencioni i krimít, marrë në kuptimin e gjérë, është funksion i shërbimit të policisë. Prevencioni policor mund të shfaqet në formë të: mbikqyrjes, patrullimit, kontrollit të personave dhe mjeteve, punës paraprake operative etj. Duhet theksuar se puna operative është kruciale për parandalimin e organizimit të kriminalitetit të të gjitha llojeve. Në kuadër të prevencionit policor, bazuar në faktin se kriminaliteti ka përjetuar ekspansion (si në kuptimin gjeografik ashtu edhe teknologjitet, si dhe në modus operandi), paraqitet si domosdoshmëri bashkpunimi policor ndërkombëtar (iterpoli), bilateral dhe formave tjera. Politika kriminale duhet të planifikojë dhe programojë masa dhe veprime në aftësimin dhe përsosjen e policisë ashtu që të zbatojë drejtë, parandalimin dhe luftimin e suksesshëm të kriminalitetit.

- **Prokuroria dhe pengimi i kriminalitetit**

Prokuroria është institucion klasik i judikaturës penale i cili daton qysh para 150 vjetësh⁹⁶. Prej atëherë, institucioni i Prokurorisë është transformuar në atë masë, sa sot paraqet institucion kyq në luftimin e kriminalitetit.

Institicioni i Prokurorisë ka historinë e saj, dhe gjatë zhvillimit, ajo, në shtetet e ndryshme është disejnuar në formë të veçantë. Në këtë drejtim janë të njohura: sistemi anglosakson; sistemi francez-italian; sistemi gjerman; sistemi sovjetik etj, etj.

Fushëveprimi – të drejtat, detyrat dhe kompetencat e Prokurorit Publik më afér janë paraparë me norma imperative. Kështu me dispozitat e nenit 109 të Kushtëtutes së Kosovës, Prokurori i shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale... me ligj. Ligji për Prokurorin e shtetit (Ligji nr.03/L-225), në dispozita të nenit 7 dhe 8 parashevë detyrat, kompetencat dhe veprimtarin parandaluse të prokurorit⁹⁷.

Derisa dispozitat e cekura të Kushtetutës dhe Ligjit për prokurorin e shtetit parashohin rregulla të përgjithshme të aktivitetit të Prokurorisë Publike, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, detyrave dhe kompetencave të Prokurorit i'a kushton kapitullin e IV, i cili me dispozitat e neneve 46 deri 52, në mënyrë të detajuar përcakton veprimtarin e Prokurorit në luftimin e kriminalitetit, duke filluar nga ndjekja penale, akuzimi e deri në fazën e fundit (apelit) të procedimit penal.

Autorizimet e prokurorit në shumë shtete të sotme evropiane janë të rregulluara me legjislacion penal, ashtu që, prokurori ka rol “zotëruesh” në hetimet paraprake. Funksionet e prokurorit

⁹⁶ Latifi Vesel, “Politika Kriminale”, Prishtinë, 2011, fq.115;

⁹⁷ Ligji për prokurorin e shtetit (Ligji nr.03/L-225), Prishtinë, 2010;

Sipas dispozitave të nenit 7 të Ligjit për prokurorin e shtetit, detyrat dhe kompetencat e prokurorit përfshijnë: ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme. Neni 8 i Ligjit të cituar konstaton se: Prokurori i shtetit bashkëpunon me ishtolucionet shtetërore dhe subjektet tjera publike e private në aktivitet lidhur me edukimin e shoqërisë me qëllim të ngritjes së njohurive për Ligjin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale.

ushtrohen në mbështetje të kompetencave lëndore dhe territorial të Gjykatës pranë së cilës ai vepron.

Në kuadër të luftës kundër sjelljes së ligjit, Prokurori është i obliguar ta mbikqyrë respektimin e ligjshmërisë në procedurën penale.

- **Gjykata dhe luftimi i kriminalitetit**

Gjykatat apo sistemi gjyqësor, janë instanca të pavarura, të cilat në procedimin e rasteve penale, të ndërlidhura me legjislacionin penal luftojnë kriminalitetin dhe aplikojnë sanksionet penale.

Të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e Gjykatave në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit burojnë nga Kushtetuta e Kosovës, Kodi i Procedurës Penale dhe ligjet tjera specifike, me të cilat më afër rregullohen këto çështje. Kështu, Kushtetuta e Kosovës, në nenin 7 parashevë në mënyrë të përgjithësuar vlerat të cilat mbrohen me Kushtetutë siq janë: prona, liritë, të drejtat e njeriut etj. Ndërsa, në kapitullin II, prej nenit 25 e deri në nenin 56 më përafërsisht janë të parapara vlerat të cilat i mbrojnë Gjykatat kompetente, dhe në atë mënyrë kontribuojnë në luftimin e kriminalitetit. Kodi i Procedurës Penale, gjithashtu, me dispozita përkatëse rregullon kompetencat e Gjykatës në luftimin e kriminalitetit. Edhe Ligji për Gjykata (nr.03/L-199) në më të detajuar zbërthen funksionet, kompetencat dhe detyrimet e Gjyqësorit në Kosovë. Qëllimi themelor dhe kryesor i këtij Ligji është të mundësoj luftimin e suksesshem të kriminalitetit dhe zbatimin e Ligjit në të gjitha nivelet.

Në procedimin e rastit, bartësi i funksionit të gjyqësorit – gjyqtari, duhet:

- Të zgjedh alternativën (mundësin) që i ofron norma penale në funksion të qëllimit të politikës ndëshkimore;
- Në kontekst të zgjedhjes së “alternativës”, të ketë parasysh elementet objektive dhe subjektive;
- Të vlerësojë rrezikshmërin shoqërore të veprës penale;
- Të përcaktojë politikën e dënimit;
- Gjykimin ta harmonizojë me konceptin e risocializimit (qëllimi themelor i dënimit); dhe
- Për të gjitha të vendos në bazë të Ligjit dhe në mënyrë të pavarur⁹⁸.

Aktiviteti gjyqësor është proces – procedure i/e cili i nënshtrohet respektimit të parimeve të caktuara, sa vijon:

- Puna e gjyqtarit duhet të kuptohet si punë analitike, si proces studioz, i sintetizuar dhe i integruar;
- Nevojiten njohuri të thelluara nga e drejta penale, kriminologjia, etj;

⁹⁸ Latifi Vesel, “Politika Kriminale”, Prishtinë, 2011, fq.134;

- Të ketë orientim humanitar dhe etikë të lartë; dhe
- Ngritjen e personalitetit të gjyqtarit mbi bazën e parimeve morale.

Në këtë kontekst, Gjykatave dhe gjyqtarëve u përket roli shumë i rëndësishëm në lëmin e politikës kriminale. Politika ndëshkimore si pjesë e politikës kriminale, që pikësynimin e aktivitetit të vet e vendos në individualizimin e sanksioneve penale, sendërtohet nëpërmjet institucioneve të judikaturës penale, apo nëpërmjet gjyqtarëve dhe gjykatave, si titullar të realizimit të drejtpërdrejt të politikës kriminale. Në këtë aspekt, gjyqësia është shumë prapa nëse kihet parasysh shfrytëzimi i shkencave bashkëkohore dhe njohurive shkencore. Kjo mungesë e njohurive të nevojshme për kryerjen e detyrës gjyqësore mundëson zbatimin e dobët të së drejtës⁹⁹.

Mirëpo, pavarësisht nga të gjitha të metat e theksuara më lartë, Gjyqësia është e pazëvendësueshme në lëmin e luftës kundër krimit, së këndejmi, është imediate forcimi, zhvillimi dhe aftësimi profesional, për një funksionim efikas në fushën e politikës kriminale. Roli i cituar i Gjyqësisë është vendimtar, sepse, nëse Gjykatat nuk kryejnë funksionin e tyre të paraparë me Ligj, atëherë politika ndëshkimore, legjislacioni penal, judikatura penale dhe aktivitetet e subjekteve tjera në programin e një platforme të veçantë të politikës kriminale nuk do të kenë sukses.

4.1.3 Politka ndëshkimore – ndikimi i sanksioneve penale dhe ekzekutimi i tyre në parandalimin e veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare.

Politika ndëshkimore është fushë e posaçme e politikës kriminale të vendeve të caktuara në procesin e luftimit të kriminalitetit. Ajo përfshin luftën juridiko-penale kundër kriminalitetit¹⁰⁰.

Lufta juridiko – penale kundër kriminalitetit përfshin shqiptimin e sanksioneve penale ndaj kryesve të veprave penale, si dhe ekzekutimin e tyre. Ky kompleks i masave që ndërmerrën ndaj kryesve të veprave penale vënë në veprim strukturat e caktuara shtetërore – Policin, Prokurorin, Gjykatën, institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale, dhe institucionet tjera. Angazhimi i këtyre institucioneve dhe masat e veprimet e ndërmarra kanë për qëllim risocializimin dhe veprimin preventiv ndaj kryesve potencial të veprave penale.

Në kutptim të jetësimit të rregullave të cilat përcaktojnë kufijtë e tolerancës së veprimit të individëve të caktuar në situata dhe rrethana të caktuara, politika ndëshkimore, respektivisht, aplikimi i sanksioneve penale dhe ekzekutimi i tyre paraqesin mjete të domosdoshme të mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti. Kjo është arsyja themelore pse tanë për tanë shoqëria nuk mund të heq dorë nga funksioni ndëshkimor i shtetit – sanksionet penale.

Natyrisht, kjo nuk parajshton mundësin që në të ardhmen, nën kushte tjera shoqërore, mjetet e dhunës shtetërore të mos jenë domosdoshmëri. Krijimi i këtyre kushteve imponon nevojën që

⁹⁹ Latifi Vesel, "Politika Kriminale", Prishtinë, 2011, fq.135;

¹⁰⁰ Rexhep Gashi, "Politika Ndëshkimore ndaj delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980-1989", Prishtinë, 2003, fq.62;

shoqëria në kontinuitet të zhvillojë dhe përsosë ligjet penale dhe ngris kapacitetet professionale dhe teknike për zbatimin sa më me sukses të tyre.

Justifikimi i ekzistimit të sanksioneve penale në procesin e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit, politika ndëshkimore nënkupton rolin e saj të dyfishtë, preventiv dhe represiv, me tendencë që të mbizotëroj roli preventiv.

Në këtë kontekst, Kodi Penal i Kosovës, në nenin 34 parasheh qëllimin e dënimit, i cili konsiston në parandalimin e kryesit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tij, dhe ndikimin në personat tjerë në kuptim të largimit të tyre nga kryerja e veprave penale. Dispozita pothuajse të njejtë përmban edhe nenin 41 i Kodit të ri Penal të Kosovës. Mirëpo, duhet patur parasysh se me ndjekjen penale dhe masat tjera represive nuk mund të ndikohet në mënyrë vendimtare në evitimin e kriminalitetit¹⁰¹.

Qëndrimet e theksuara teorike për domosdoshmërin e sanksioneve penale apo mohimin e tyre nuk zvogëlojnë aplikimin e tyre në politikën ndëshkimore. Në këtë kuadër kujdes i posaçëm i kushtohet dënimive (...sanksionet më të vjetra penale të cilat kanë karakter represiv por kanë edhe dimensionin e risocializimit...).

4.1.4 Luftimi i kriminalitetit pasuror si pjesë e Strategjisë Kombëtare për luftimin e kriminalitetit

Në këtë kapitull, kemi trajtuar rolin e **faktorëve preventive** (themelor, ndërkombëtar dhe shkencor); dhe **faktorëve represiv** (Policia, Prokuroria, Gjyqësori dhe institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale), në parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi, dhe të delikteve pasurore në veçanti. Mirëpo, trajtimi i këtyre çështjeve nuk është gjithëpërfshirëse, dhe nuk jep përgjegje në çështjen thelbësore të prevencës kriminale.

Konsiderojm se, në planin e luftimit të prevencës kriminale, Kosova duhet të hartojë Stratëgjinë Kombëtare për luftimin e kriminalitetit. Stratëgjisë Kombëtare duhet t'i paraprin hartimi i një “kornize fillestare” (... të dhënat bazë për hartimin e stratëgjisë...), i cili mund të mbështetet në përvojat më të mira të shteteve të cilat kanë krijuar një traditë në këtë aspekt. Në këtë drejtim mund të shfrytëzohet edhe udhëzuesi për prevencën kriminale të zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogë dhe kriminalitet¹⁰².

Korniza fillestare e Stratëgjisë Kombëtare për prevencën kriminale duhet të përfshijë, sa vijon:

- Kriminalitetin e drogave;
- Deliktet pasurore;
- Deliktet e të miturve; dhe

¹⁰¹ Millutinoviq Millan, “Kriminologja”, përkthim në gjuhën shqipe, Prishtinë, nuk ka vit të botimit, fq.477;

¹⁰² Guidelines for the Prevention of Crime and Economic Social Council resolution – 2003/13 of 24 July 2002;

- Të gjitha trajtat tjera të kriminalitetit.

Kategorit e cekura të kriminalitetit duhet vlerësuar, hulumtuar dhe trajtuar në aspektin interdisiplinar, në mënyrë që të përceptohen çështjet relevante për luftimin e këtyre veprave penale. Në kontekst të kriminalitetit kundër pasurisë, e veçanërisht, veprat penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, konsiderojmë se të dhënat e paraqitura për fenomenologjin, etiologjin, në Stratëgjin Kombëtar për luftimin e kriminalitetit nga një organ i posaçëm i cili do të funksiononte pranë Qeverisë së Kosovës. Ky organ duhet të jetë i përfaqësuar nga organet e sigurisë, prokurorisë dhe të gjyqësisë.

PËRFUNDIM

Të gjitha sistemet moderne juridiko – penale, në grupin e veprave penale kundër pasurisë parashohin veprat penale të vjedhjes grabitqare dhe të grabitjes me pothuajse përbajtje të ngjashme e sendit të huaj të luajtshëm me përdorimin e dhunës...).

Hulimtimi i bërë i aspekteve juridiko – penale të veprave penale kundër pasurisë në përgjithësi, ndërsa të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes në veçanti, vënë në pah faktin se kemi të bëjmë me veprat penale, të cilat përveç pasurisë atakojnë edhe jetën e trupin e njeriut, që është veçori dalluese e këtyre veprave penale, nga veprat tjera penale kundër pasurisë.

Të dhënat statistikore për periudhen: 2006 – 2012, për prezncën e këtyre veprave penale në territorin e Gjykatës së Qarkut Pejë dhe Gjykatës Themelore Gjakovë, flasim për oscilime të caktuara, prej viti në vit në paraqitjen e tyre, dhe kjo, krahasuar me regionet tjera të Kosovës e edhe më gjërë nuk është përjashtim. Mirëpo, duhet theksuar se numri i këtyre veprave penale nuk duhet të jetë kriter i vlerësimeve hulumtuese, sepse, mbështetur në mënyrën e kryerjes, mjetet e përdorura për kryerjen e këtyre veprave penale dhe pasojën, veprat penale të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes janë vepra të rrezikshmërisë së lartë.

Hulumtimi i bërë përkitazi me paraqitjen e veprave penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare ne territorin e Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe Gjykatës Themelore të Gjakovës në periudhën 2006 – 2012, jap një pasqyre reale të fenomenologjisë dhe etiologjisë së këtyre veprave penale, si dhe përmasat e efikasitetit të politikave kriminale në procesin e parandalimit të këtyre krimeve. Të dhënat e arritura me hulumtimin e bërë tregojnë se kryes të këtyre veprave penale janë kryesisht meshkuj, të moshës mesatare – 28 vjeqe, dhe se nga numri i përgjithshëm i kryesve – 43, prej tyre janë recidivist.

Hulumtimi i cituar vërteton se numri i madh i kryesve të këtyre veprave penale kryesisht vijnë nga pjesët rurale të regionit të Pejës (...nga 43 kryes, nga pjesët rurale vijnë 27 persona...), dhe se nga numri i përgjithshëm i kryesve, pjesa më e madhe – 33 syrësh janë të varfér. Të gjitha këto të dhëna korespondojnë me rolin e faktorit ekonomiko – social, mjedisor, si dhe faktorët tjere determinues në sjelljen kriminale të kategorisë së caktuar të këtyre personave. Në këtë kontekst duhet theksuar edhe faktin se lufta e fundit në Kosovë dukshëm ka dëmtuar pozitën materiale të qytetarëve, gjë që gjithashtu paraqet faktor shtesë në vlerësimin e shkaktarëve të parqitjes se krimít.

Me qëllim të luftimit sa më të suksesshëm të këtyre veprave penale nevojitet hulumtim dhe ndriçimi i të gjitha karakteristikave dhe tipareve të qenies së këtyre veprave penale, dhe ate si nga aspekti teorik ashtu edhe ai praktik, si dhe trajtimi adekuat i masave preventive dhe politikave ndëshkimore.

Parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit në përgjithësi, e edhe i veprave penale kundër pasurisë (grabitja dhe vjedhja grabitqare) padyshim nënkupton trajtimin e këtij problemi në dy nivele, dhe ate: në rrafshin preventiv dhe ate represiv.

Të dhënët nga hulumtimi i bërë tregojnë se, veprimi i planifikuar dhe i programuar i shtetit tonë në planin e preventivës kriminale në parandalimin e këtyre veprave penale nuk është i mjaftueshëm. Këtë e vërteton fakti se, të dhënët krahasuese prej vitit 1999, për periudhën shqyrtuese, tregojnë oscilime në dy drejtime (...niveli i paraqitjes herë ulet, e herë ngritet...).

Trajtimi teorik i çështjes se rolit të masave preventive dhe repressive në parandalimin e kriminalitetit, nxjerrë përfundim se në këtë plan duhet dhënë prioritet masave preventive. Mirëpo, kjo asesi nuk përjashton nevojën e ekzistimit të masave repressive, përkundrazi, niveli aktual i zhvillimit të institucioneve përkatëse (i cili nuk është i kënaqshëm), të cilat merren me preventivën kriminale, imponon aplikimin e masave repressive. Në këtë rrafsh, ngritja e mirëfilltë e **infrastrukturës ligjore** si dhe **aftësimi profesional i bartësve të funksioneve të judikaturës** dhe pësonelit tjetër është imperativ i kohës.

Legjislacioni Penal i Kosovës, nga paslufta e tutje është në process të ndryshimeve permanente. Kështu, edhe ndryshimet e fundit të Kodit Penal të Kosovës, të bëra në vitin 2012 janë gjithashtu kontribut në këtë drejtim. Këto ndryshime veç tjerash, kanë përfshirë edhe veprat penale të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare në trajtën e tyre të cilësuar, ashtu që rastet e rënda janë fshirë si vepra të veçanta penale dhe janë përfshirë në kuadër të sanksionimit të veprave penale bazë – grabitjes dhe vjedhjes grabitqare. Konstrukcioni i ri në Kodin Penal sigurisht është më racional, dhe si i tillë do të sjellë efikasitet në cilësimin dhe gjykimin e këtyre çështjeve penale. Natyrisht, këto ndryshime nuk jepin zgjidhje përfundimtare. Kështu, të dhënët statistikore (...evidencat gjyqësore...) dhe hulumtimet e bëra në nivele të ndryshme shkencore vërtetojnë se “trajtat e cilësuara të grabitjes së armatosur”, për shkak të rrezikshmerisë së saj, formave të shfaqjes, si dhe pasojave direkte – ndaj viktimateve të rasteve penale, dhe indirekte – shkaktimi i pasigurisë në opinionin e gjërit, imponon trajtimin e veçantë nga ligjdhënësi, respektivisht, sanksionimin e kësaj vepre penale si vepër e veçantë, e cila do të rezultonte edhe me dënlime më të rënda.

Hulumtimi i bërë tregon se judikatura Kosovare është ende larg standardit i cili garanton zbatim efikas të Ligjit dhe aplikimit të një politike efikase ndëshkimore. Në fakt, jemi dëshmitar të defekteve të shumta në realizimin efikas të procedurës parapenale dhe penale, si dhe në procedurat ankimore (...zvarritjet e shumta pothuaj në të gjitha fazat e procedurës penale...). Mendojmë se në të ardhmen, Gjykatat duhet të janë më efikase (azhure) në trajtimin e këtyre çështjeve penale, e nga ana tjetër t'i kushtojnë vemendje të posaçme kriterit në shqiptimin e dënlimeve në mënyrë që sa më mirë të arrihet qëllimi i ndëshkimit, ashtu që kryesit e këtyre veprave penale të risocializohen dhe të mos janë pre e recidivës penale.

Rezultatet e prezantuara të hulumtimit të bërë duhet të janë bazë për ndërtimin e politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit. Në këtë drejtim hartimi, miratimi dhe zbatimi i një Strategji Kombëtare në luftimin e kriminalitetit në përgjithësi, e të veprave penale kundër pasurisë në veçanti, do të ishte një hap i rëndësishëm.

LITERATURA

I. Libra, Monografi dhe punime kërkimore shkencore

1. Salihu, Ismet, “E drejta penale – pjesa e përgjithshme”, Prishtinë, 2008;
2. Salihu, Ismet, “E drejta penale ndërkomëtare penale”, Prishtinë, 2011;
3. Elezi, Ismet, “E drejta penale - pjesa e posaçme” – Tiranë, 2003);
4. Nushi, Pajazit, “Psikologjia”, Prishtinë, 1996;
5. Latifi, Vesel, “Kriminalistika”, Prishtinë, 2011;
6. Latifi, Vesel, “Politika Kriminale”, Prishtinë, 2011;
7. Ukaj, Bajram, “Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë”, Prishtinë, 2006;
8. Gashi, Rexhep, “Politika ndëshkimore ndaj delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980 – 1989”, Prishtinë, 2003;
9. Halili, Ragip, “Kriminologjia”, Prishtinë, 2005;
10. Dimitrijević, Vojin, “Terorizam”, Beograd, 1983;
11. Serzentiq, Nikolla dhe Dr. Stajiq, Aleksandar, “E drejta Penal”, Prishtinë, 1997;
12. Zvekić, U, “Žrtve kriminala u zemljama u tranziciju”, Beograd, 2001;
13. Stojanović, Z, dhe Perić, O, “Krivično pravo – posebni deo”, Beograd, 2007;
14. Knežić, B, dhe Mr.Jovanović, S, “Razbojništvo i razbojnička kradja”, Beograd, 2007;
15. Milutinović, Milan, “Kriminologjia”, Prishtinë, (nuk ka vit të botimit);
16. Banović, B, “Kriminalističko – kriminiloski aspekti krivičnog dela razbojništva”, Beograd, 2002;
17. Atancković, Dragoljub, “Krivično pravo – posebni deo”, Beograd, 1985;
18. Ljubiša, Lazarević, “Krivično pravo – posebni deo”, Beograd, 1981;
19. Đordjević, D, “Krivično delo razbojništva i uloga policije u njegovoj prevenciji” Beograd, 2002;
20. Dvoršek, Anton, “Značaj kriminalne strategije za prevenciju kriminaliteta”, Beograd, 2002;
21. Milosavljević, Branko, “Socijalna patologija i društvo, Beograd, 1981;
22. Matijević, Mile, “Otkrivanje imovinskih krivičnih djela na osnovu tragova primjenom kriminalističkog modeliranja i geografskog profilisanja”;
23. Modly, D, “Metodika istraživanja razbojništva”, FKN, Sarajevo, 1999;
24. Simonović, B, “Kriminalistika”, Kragujevac, 2004; dhe
25. Čeđović, Bora, “Krivično pravo u sudskoj praksi, druga knjiga, posebni deo”, Beograd 1985.
26. Zejneli, Ismail, “E drejta penale - pjesa e posaçme” – Tetovë, 2007);

II. Kushtetuta, Kode, Ligje, Udhëzues, Kanune dhe Leksikone

1. Kushtetuta e Kosovës, Prishtinë, 2008;
2. Ligji Penal i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1977;
3. Ligji Penal i RSFJ, Prishtinë, 1978;
4. Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2003;
5. Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2012;
6. Kodi Penal i Shqipërisë;
7. Shtjefen, Gjeçovi, OFM, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Tiranë, 1999;
8. Kodet Penale të shteteve tjera: Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë, Malit të Zi, Sërbisë, Bosne e Hercegovinë, Republikës Sérbe, RF.Gjermanisë, Sllovenisë dhe Bullgarisë;
9. Ligji për Policinë, nr.04/L-076, 2012;
10. Udhëzuesi për prevencën kriminale të zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogë dhe kriminalitet, “Guidelines for the Prevention of Crime the Economic Social Council resolution – 2003/13 of 24 july 2002;
11. The Penal Code of California,
<http://www.leginfo.ca.gov/cgibin/displaycode.....>;
12. The Criminal Justice Code of Neë Jersej, Neë York, 1984, Gould Publications; dhe
13. The Criminal Justice Code of Ilionis 1961,
<http://www.legis.il.us/legislation/icls/ch.....>;
14. Jovašević, Dragan, “Leksikon krivičnog prava”, Beograd, 1998; dhe
15. Vujaklija, M, “Leksikon stranih reči i izraza”, Beograd, 1970.

III. Komentar dhe Revista

1. Elezi, Ismet dhe Dr. Kaqipi, Skender, “Komentari i Kodit Penal të Shqipërisë”, Tiranë;
2. Salihu, Ismet dhe Dr. Hasani, Fejzullah dhe Mr. Zhitia, Hilmi, “Komentari i Kodit Penal i Republikës së Kosovës”, 2014, Prishtinë;
3. Komentar Krivičnog Zakona SFRJ – 1978;
4. Tahović, Janko, “Komentar krivičnog prava”, Beograd, 1962;
5. Serzentić, Nikola, “Komentar krivičnog zakona Srbije, SAP Kosova i SAP Vojvodine”, Beograd, 1981;
6. Bavcon, Ljubo, “Problemi i dileme naše kriminalne politike u doba socijalno političke krize, JRKK, nr.3-4”, Beograd, 1984;
7. Jovašević, Dragan, “Teži oblici razbojništva i razbojničke kradje, Časopis Bezbednost”, 2/2002 dhe 2/2005, Beograd; dhe
8. Lazarević, L, “Povratnici, delikuenti po navici, profesionalni delikuenti po tendenciji u savremenom krivičnom pravu”, JRKKP, Beograd, 1966/1.

IV. Vendime të Gjykatës së Qarkut në Pejë

1. **Aktgjykimi, P.nr.232/10, dt.11.10.2010;**
2. -----, P.nr.107/11, dt.27.06.2011;
3. -----, P.nr.239/09, dt.24.06.2009;
4. -----, P.nr.139/08, dt.30.07.2008;
5. -----, P.nr.43/08, dt.30.11.2010;
6. -----, P.nr.327/09, dt.15.12.2009;
7. -----, P.nr.210/11, dt.04.07.2011;
8. -----, P.nr.433/07, dt.06.07.2007;
9. -----, P.nr.475/06, dt.13.04.2007;
10. -----, P.nr.127.06, dt.23.12.2010.

V. Evidence e Gjykatës Themelore Gjakovë dhe e Gjykatës së Qarkut në Pejë

1. Evidence e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë për veprat penale të vjedhjes grabitqare, grabitjes dhe raste e rënda të këtyre veprave penale, për periudhën : 2006 – 2012.

VI. Publikime në Sajte

1. <http://www.iwpr.net/?.....;>
2. <http://www.mksf-ks.org/respiratory/docs/Law.....;>
3. <http://www.legis.il.us/legislation/icsl/ch.....;>
4. <http://www.leginfo.ca.gov/cgi-bin/displaycode...;>
5. www.zenicablog.com/index.php.....;
6. www.tip.ba....;
7. www.rtv.rs/sr-lat/hronika; dhe
8. www.nezavisne.com/novosti/hronika.